

Agjenda për Reforma Evropiane

Raporti i Monitorimit për vitin 2018



Shkurt 2019

AGJENDA PËR REFORMA EVROPIANE: Raporti i monitorimit për vitin 2018

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti GAP dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike, Shkurt, 2019.

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, Institutit GAP apo Institutit të Prishtinës për Studime Politike, donatorët e këshillit, stafit të tyre, apo anëtarëve të bordit. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, Institutit GAP apo Institutin e Prishtinës për Studime Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

“Rexhep Luci” rruga 16/1

Prishtina 10 000,

Webfaqja: www.legalpoliticalstudies.org

E-mail: office@legalpoliticalstudies.org

Tel/fax.: +381 38 234 456

Instituti GAP

“Sejdi Kryeziu” rruga 4/2

Prishtina 10 000,

Webfaqja: www.institutigap.org

E-mail: info@institutigap.org

Tel/fax.: +381 38 609 339

Instituti i Prishtinës për Studime Politike

“Rexhep Luci” rruga 15/5

Prishtina 10 000,

Webfaqja: www.pips-ks.org

E-mail: info@pips-ks.org

Tel/fax.: +381 38 224 577

Hyrje

Kosova, ashtu si të gjitha vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, me qëllim të forcimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, zhvillimin ekonomik dhe social, do të duhej t'i përmbahej të gjitha detyrave që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA). Me saktësisht, ky proces synon që në këto vende të ketë vazhdimisht stabilitet politik dhe bashkëpunim rajonal. Për më tepër, vendeve të cilat pretendojnë integrim në BE u kërkohet të harmonizojnë sistemet e tyre ligjore dhe ekonomike me direktivat, ligjet dhe standardet e BE-së.

Sa i përket marrëdhënieve Kosovë dhe BE, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) është marrëveshja e parë kontraktuale e cila vendos listën e reformave ekonomike, politike, ligjore dhe afatet zyrtare për zbatimin e tyre.¹

Duke e marrë parasysh që marrëveshja është mjaft sfiduese dhe me qëllim që ajo të realizohet në kohë dhe sipas kushteve të paracaktuara, Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian kanë hartuar Agjendën për Reforma Evropiane (ARE). Për më shumë, në vitin 2016 në këtë agjendë janë vendosur prioritetet kryesore të Kosovës në kuadër të MSA-së që do të duhej të përfundonin deri në fund të vitit 2017. Konkretisht, në këtë dokument janë përfshirë gjithsej 22 masa të përgjithshme, të ndara në tri shtylla kryesore, (I) Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, (II) Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve, si dhe (III) Punësimi dhe Arsimi.²

Ndërsa, organizatat që janë marrë me monitorim të ARE-së, konkretisht Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP (GAP) dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS), për vitin 2018 kanë vendosur që matricës t'i shtohen edhe masat që Qeveria ka nxjerrë në nëntor të vitit 2017 me vendimin nr. 01/13 për prioritetet kyçe të Agjendës për Reforma Evropiane për vitin 2018.³ Duke marrë parasysh se në kohën kur ky vendim u bë publik të gjitha palët e ndikuara e kishin të paqartë se me cilën agjendë të vazhdohet, atë të paplotësuarën apo me vendimin e lëshuar nga qeveria, andaj kemi vendosur që masat të bashkohen në një matricë.

Ky raport monitorimi përfshinë të arriturat e institucioneve gjatë tërë vitit 2018, megjithatë ne kemi publikuar raporte për monitorim gjashtë dhe nëntë mujor. Në mënyrë që të japim një pasqyrë të qartë mbi gjendjen dhe procesin e implementimit të ERA-së ky studim fokusohet në shtjellimin e metodologjisë dhe rezultateve të procesit të monitorimit, analizimin e gjendjes aktuale rreth të arritave dhe ngecjeve të institucioneve, si dhe ofrimin e konkluzione dhe rekomandime. Për më tepër, në aneks është paraqitur matrica me detajet dhe informatat shtesë për secilën masë.

Metodologjia e monitorimit

Rezultatet e paraqitura në këtë raport janë nga të arriturat që institucionet përgjegjëse kanë treguar gjatë vitit 2018. Masat e monitoruara janë masat e dala nga Agjenda për Reforma Evropiane dhe ato të dala nga vendimi Nr. 01/13 i lëshuar nga Qeveria në Nëntor të vitit 2017.

¹ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër. Bruksel 2015. Mund të gjendet në këtë link: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf>

² Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) (2016) Kosovë – BE Dialogu i Nivelit të Lartë për Prioritetet Kyçe. Burimi: <https://bit.ly/2fF3mr0>

³ Vendimet e Mbledhjes së 13-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës (2017). Burimi: <https://bit.ly/2M8ZX1C>

Metodologjia e aplikuar gjatë këtij procesi monitorues është bazuar në kontaktimin direkt të të gjitha institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masave dhe veprimeve të lartcekura. Konkretisht, procesi i monitorimit ka filluar me identifikimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse dhe ka vazhduar me identifikimin e detyrave që kanë pasur përsipër t'i realizojnë. Pas identifikimit të këtyre të fundit, janë përpiluar pyetjet në mënyrë që të sigurohen detaje se ku gjendet procesi dhe arsyet e vonesave. Pastaj, janë dërguar posta elektronike(email) tek sekretarët e përgjithshëm dhe zyrtarët e integrameve evropiane, për të kërkuar informacione rreth zhvillimeve të parapara në agjendë. Në disa raste, institucionet janë kontaktuar edhe përmes telefonit.

Informacionet e marra janë krahasuar me raportet e Ministrisë për Integrame Evropiane (MIE), dokumentet publike në web faqet e institucioneve përgjegjëse dhe nëse ka pasur ndonjë paqartësi kemi kërkuar edhe takime në këto institucione, ashtu që rezultatet të mund të zbërthehen në atë nivel që të jenë sa më të kuptueshme.

Të arriturat e institucioneve përgjegjëse janë ndarë në tri kategori:

- **Të plotësuara plotësisht** – janë përcaktuar masat dhe veprimet të cilat janë realizuar në tërësi dhe sipas kriterëve të parapara. Mirëpo, nuk është marrë parasysh koha e paraparë për tu përmbushur sepse një numër i caktuar i masave nuk është realizuar në periudhën e paraparë në këtë agjendë. Këto masa dhe veprime, në matricën e paraqitur në shtojcë, janë të identifikuara me ngjyrën e gjelbër.
- **Pjesërisht të plotësuara** – janë përcaktuar masat dhe veprimet të cilat janë në realizim e sipër por për arsye të ndryshme procesi i kompletimit të tyre ka ngecur. Këto masa, në matricë, janë të identifikuara me ngjyrë të verdhë.
- **Të paplotësuara** – janë përcaktuar masat dhe veprimet për të cilat nuk është punuar asgjë. Këto masa, në matricë, janë të identifikuara me ngjyrë të kuqe.

Matrica është e ndarë në tre shtylla kryesore të ERA-së. Më saktësisht, shtylla e parë, Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, është monitoruar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, shtylla e dytë, Konkurrueshmëria dhe Klima Investimeve, është monitoruar nga Instituti GAP, dhe shtylla e tretë, Punësimi dhe Arsimi, është monitoruar nga Instituti i Prishtinës për Studime Politike. Për secilën masë, në matricë është dhënë sqarimi se kur ka filluar procedura e realizimit të tyre dhe nëse ka përfunduar, kur ka ndodhur kjo. Mirëpo, nëse masat nuk janë plotësuar ende atëherë është sqaruar se ku gjendet procesi. Masat dhe veprimet janë të parapara të realizohen në periudha të ndryshme kohore gjatë vitit, andaj në matricë me TM1 është paraqitur tre mujori i parë i vitit apo periudha Janar – Mars, pastaj me TM2 është paraqitur tremujori i dytë i vitit apo periudha Prill – Qershor, me TM3 është paraqitur tremujori i tretë i vitit apo periudha Korrik – Shtator, dhe me TM4 është paraqitur tremujori i katërt i vitit apo periudha Tetor – Dhjetor.


Rezultatet e Procesit të Monitorimit

Agjenda për Reforma Evropiane përcakton 29 masa, të ndara në tri shtylla kryesore:


- I. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit,
- II. Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve dhe
- III. Punësimi dhe Arsimi.

Nga 29 masat që përcakton ERA janë identifikuar 108 veprime, 68 veprime apo 62.96% e tyre janë plotësuar në tërësi, 21 veprime apo 19.44% janë plotësuar pjesërisht dhe 19 veprime apo 17.60% mbesin të paplotësuara. Ndërsa nga masat, 10 janë plotësuar në tërësi, 15 janë plotësuar pjesërisht dhe 4 mbesin të paplotësuara, të cilat në mënyrë ilustruese mund të shihen në grafikët 1 dhe 2.

Sa i përket secilës shtyllë, shtylla e parë parasheh 11 masa me gjithsej 37 veprime, shtylla e dytë parasheh 12 masa me gjithsej 44 veprime dhe shtylla e tretë parasheh 6 masa me gjithsej 27 veprime. Nga 37 veprimet e dala prej 11 masave të Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit: 72.97% e veprimeve janë plotësuar në tërësi, 16.22% e veprimeve janë pjesërisht të plotësuara, dhe 10.81% e veprimeve mbesin të paplotësuara. Nga 44 veprimet e dala prej 12 masave të Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve: 56.82% e veprimeve janë plotësuar në tërësi, 22.73% e veprimeve janë pjesërisht të plotësuara, dhe 20.45% e veprimeve mbesin të paplotësuara. Nga 27 veprimet e dala prej 6 masave të Punësimi dhe Arsimi: 59.26% e veprimeve janë plotësuar në tërësi, 18.52% e veprimeve janë pjesërisht të plotësuara, dhe 22.22% e veprimeve mbesin të paplotësuara.



Grafiku 1. Gjendja e masave të ARE-së



Grafiku 2. Gjendja e veprimeve të ARE-së

Institucione përgjegjëse për shtyllën e parë ishin Kuvendi, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Administratës Publike, Komisioni Qendror për Zgjedhje, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë. Institucionet përgjegjëse për shtyllën e dytë ishin Zyra e Kryeministrit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës. Institucionet përgjegjëse për shtyllën e tretë ishin Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

MASA	VEPRIMET	E PLOTËSUAR	%	PJESËRISHT E PLOTËSUAR	%	E PAPLOTËSUAR	%	GJENDJA E MASAVE NË FUND TË VITIT 2018
QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIQJIT								
Masa 1	4	3	75%	1	25%	-	-	Pjesërisht e plotësuar
Masa 2	3	3	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
Masa 3	3	3	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
Masa 4	3	3	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
Masa 5	1	-	-	-	-	1	100%	E paplotësuar
Masa 6	5	4	80%	1	20%	-	-	Pjesërisht e plotësuar
Masa 7	2	-	-	-	-	2	100%	E paplotësuar
Masa 8	4	3	75%	1	25%	-	-	Pjesërisht e plotësuar
Masa 9	4	3	75%	-	-	1	25%	Pjesërisht e plotësuar
Masa 10	3	-	-	3	100%	-	-	Pjesërisht e plotësuar
Masa 11	5	5	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
KONKURRUESHMËRIA DHE KLIMA E INVESTIMEVE								
Masa 12	3	-	-	-	-	3	100%	E paplotësuar
Masa 13	1	-	-	-	-	1	100%	E paplotësuar
Masa 14	1	1	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
Masa 15	2	1	50%	1	50%	-	-	Pjesërisht e plotësuar
Masa 16	5	1	20%	-	-	4	80%	Pjesërisht e plotësuar
Masa 17	3	1	33.33%	2	66.67%	-	-	Pjesërisht e plotësuar
Masa 18	5	5	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
Masa 19	8	5	62.5%	3	37.5%	-	-	Pjesërisht e plotësuar
Masa 20	1	1	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
Masa 21	5	5	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
Masa 22	5	2	40%	2	40%	1	20%	Pjesërisht e plotësuar
Masa 23	5	3	60%	2	40%	-	-	Pjesërisht e plotësuar
PUNËSIMI DHE ARSIMI								
Masa 24	7	7	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
Masa 25	2	2	100%	-	-	-	-	Plotësisht e plotësuar
Masa 26	3	1	33.33%	1	33.33%	1	33.34%	Pjesërisht e plotësuar
Masa 27	3	1	33.33%	1	33.33%	1	33.34%	Pjesërisht e plotësuar
Masa 28	7	4	57.14%	2	28.57%	1	14.29%	Pjesërisht e plotësuar
Masa 29	5	1	20%	1	20%	3	60%	Pjesërisht e plotësuar
TOTALI	108 veprime	68 veprime	62.96%	21 veprime	19.44%	19 veprime	17.60%	Në total janë, 29 masa, nga të cilat: - 10 janë plotësuar plotësisht - 15 janë plotësuar pjesërisht - 4 mbesin të paplotësuara


Tabela 1. Rezultatet totale për secilën masë

Gjendja aktuale

Statistikat e nxjerra në vitin 2017 dhe këto të vitit 2018 na mundësojnë të shohim një përmirësim në implementimin e këtyre masave dhe veprimeve. Mirëpo, nuk mund të konsiderohet një avancim i Agjendës për Reforma Evropiane sepse kjo e fundit do duhej të ishte plotësuar deri në fund të vitit 2017.

Gjatë vitit 2017, institucionet kosovare kanë arritur t'i përmbushin vetëm 38.9% të objektivave, 47% ishin përmbushur pjesërisht dhe 14.1% nuk ishin plotësuar.⁴ Sado që kjo është pozitive, këto masa nuk janë plotësisht të krahasueshme me vitin 2018 sepse në monitorim kemi bashkangjitur edhe masat e dala nga vendimi i qeverisë.

Nga grafiku 2, i paraqitur më poshtë, mund të shohim se shtylla e parë apo Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, për vitin 2018, ka pasur performancën me pozitive nga të tri shtyllat.



Grafiku 2. Krahasimi statistikor ndërmjet tri shtyllave të Agjendës për Reforma Evropiane

Po u ndalëm të analizojmë secilën shtyllë të ERA -së, mund ta kuptojmë gjendjen më në detaje dhe arsyet për sukseset dhe dështimet e institucioneve përgjegjëse.

Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit

Shtylla e parë është e ndarë në tri kategori kryesore: Sundimi i Ligjit, Reforma Zgjedhore dhe Reforma e Administratës Publike. Masat e parapara në kategorinë e sundimit të ligjit janë: Miratimi i legjislacionit duke e bërë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik, përkatësisht të akuzuarve dhe të dënuarve për korrupsion; Plotësimi - ndryshimi i Ligjit për Konflikt Interesi; Plotësim - ndryshimi i Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit për të mundësuar rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe krimin të nivelit të lartë; Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë. Masat e parapara të fusha e Reformës Zgjedhore janë Përgatitja e pakos ligjore për reformën zgjedhore, duke përfshirë

⁴ ERA e Ngecjes; Albana Merja, Delfinë Elshani, Njomza Mjeku; Maj 2018, Prishtinë. Raporti mund të lexohet në këtë link: <http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2018/06/ERA-policy-note-final-1.pdf>

rekomandimet e misionit vëzhgues të BE-së dhe kërkesa për opinion nga komisioni i Venedikut; Përgatitja e Ligjit për financimin e partive politike dhe kërkesa për opinion nga komisioni i Venedikut; Përfundimi i auditimit të financave të partive politike; dhe Publikimi i raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj. Ndërsa masat e parapara të Reforma e Administratës Publike janë: Zbatimi i Planit për racionalizimin e agjencive të pavarura dhe organeve qendrore në kuadër të Qeverisë; Sigurimi i një procesi të përzgjedhjes që është transparent, i bazuar në merita dhe jo-politik, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe në kompani publike; Miratimi i pakos ligjore për reformë të Administratës Publike; Fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit Ekonomik dhe Divizionit Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës së Shkallës së Parë në Prishtinë, përfshirë në fushat e tatimit dhe doganave, me qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara.

Tutje, miratimi i legjislacionit duke e bërë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik, përkatësisht të akuzuarve dhe të dënuarve për korrupsion ishte paraparë të përfundohet në tremujorin e fundit të vitit 2017, mirëpo edhe pse kemi arritur në fund të vitit 2018 kjo masë mbetet pjesërisht e plotësuar. Konkretisht, veprimet që dalin nga kjo masë janë plotësuar në periudha të ndryshme kohore. Për më saktë, në nëntor të vitit 2017 është bërë aprovimi i koncept dokumentit për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion; Pastaj, në prill të vitit 2018 Qeveria ka miratuar Kodin Penal të Kosovës;⁵ Ndërsa, në nëntor të vitit 2018 Kuvendi ka miratuar Projekt Kodin Penal të Kosovës;⁶ Sa i përket Kodit të Procedurës Penale, në dhjetor të vitit 2018 është dërguar në Qeveri për shqyrtim dhe aprovim.

Pastaj, masa lidhur me plotësim – ndryshimin e Ligjit për Konflikt Interesi ishte paraparë të plotësohet në tremujorin e fundit të vitit 2016, mirëpo u plotësua në tërësi në tre mujorin e parë të vitit 2018. Pavarësisht kësaj, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ishte tërhequr nga procedura dy herë, ndërsa në fazën e tretë është hartuar Projektligji i Ri, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Agjencisë kundër Korrupsion dhe ekspertët e Këshillit të Evropës dhe Zyrës së BE-së në Kosovë. Në mars të vitit 2018 Kuvendi miratoi Projektligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.⁷

Meqenëse, plotësim - ndryshimi i Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit për të mundësuar rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe krimet të nivelit të lartë nuk ishte plotësuar në tremujorin e dytë të 2017, siç ishte paraparë në fillim, mirëpo është miratuar në tre mujorin e parë të vitit 2018. Në fillim projektligji, përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, është kritikuar se është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe prioritetet që dalin nga Agjenda për Reforma Evropiane (ERA). Ndërsa, në mars 2018 Kuvendi miratoi Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit.⁸

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë nuk ka qenë i paraparë në Agjendën për Reforma Evropiane, mirëpo të Vendimi i lëshuar nga Qeveria në Nëntor të 2017 dhe pjesë e matricës së masave afatshkurtra të Plogramit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për vitin 2018, ku ishte caktuar

⁵ Miratimi i Projekt Kodit Penal nga Qeveria. Burimi për informata shtesë: <http://kryeministri-ks.net/qeveria-e-kosoves-ka-miratuar-projekt-kodin-penal-te-republikes-se-kosoves/>

⁶ Miratimi i Projekt Kodit Penal nga Kuvendi. Burimi për informata shtesë: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_11_15_10_7721_al.pdf

⁷ Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Burimi për informata shtesë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>

⁸ Ligji Nr. 06/L-025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-034. Burimi për informata shtesë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16266>

të përfundoj gjatë tre mujorit të parë të vitit 2018. Sido që të jetë, në nëntor të vitit 2018, ky projektligj ishte miratuar nga Kuvendi.⁹

Lidhur me përgatitjen e pakos ligjore për reformën zgjedhore, duke përfshirë rekomandimet e misionit vëzhgues të BE-së dhe kërkesën për opinion nga komisioni i Venedikut, nuk është punuar asgjë. Kjo masë ishte paraparë në vendimin e lëshuar nga Qeveria, mirëpo, asnjë nga institucionet përgjegjëse nuk e kanë marrë parasysh.

Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike në prill të vitit 2018 është dërguar në Komisionin e Venedikut për shqyrtim. Pastaj, në qershor të vitit 2018 përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës kanë marrë pjesë në sesionin plenar të 115-të, të Komisionit të Venedikut, ku kanë prezantuar Projektligjin për Financimin e Subjekteve Politike. Ky i fundit ishte miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe në tetor të vitit 2018 është proceduar në Kuvend, megjithëse edhe në fund të 2018 –ës ende nuk është miratuar nga Kuvendi.

Edhe pse, Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike në janar të vitit 2018 ka aprovuar kërkesën që 10 auditorë të merren me auditimin e raporteve financiare për vitin 2017 është dashur të dërgohet në ri-tenderim për herën e tretë, pasi që procesi i përzgjedhjes ka dështuar 2 herë radhazi. Kërkesa është publike, mirëpo, edhe pas takimeve konsultative me operatorët ekonomik, nuk ka pasur kërkesa të dërguara nga operatorët ekonomik. Kjo gjendje nuk ka ndryshuar gjatë tërë vitit.

Ndërsa, Plani për Racionalizimin e Agjencive të Pavarura dhe Organeve Qendrore në kuadër të Qeverisë dhe Koncept Dokumenti për valën e racionalizimit dhe vendosjes së vijave të llogaridhënies për agjencitë të cilat funksionojnë në Kuvendin e Kosovës, janë hartuar dhe dërguar për konsultime paraprake pas gjetjeve nga analiza e bërë në mars të 2017.

Sigurimi i një procesi të përzgjedhjes që është transparent, i bazuar në merita dhe jo-politik, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe në kompani publike, e konsideruar nga Ministria për Integritet Evropian si një masë e plotësuar, vazhdon të mbetet pjesërisht e plotësuar. Kjo pasiqë institucionet përgjegjëse nuk kanë publikuar CV-të e personave që kanë qenë në listën e ngushtë gjatë rekrutimit të anëtarëve të Bordeve për Ndërmarrje Publike. Pra, ne nuk kemi mundësi t'i shohim CV-të dhe të kuptojmë se kush ka qenë në këtë listë dhe kush është rekrutuar.

Në agjendë ishte paraparë që Pako ligjore për reformë të Administratës Publike, konkretisht ligjet të miratohen në TM4 2017, ndërsa koncept dokumentet në TM4 2016. Këto të fundit, ishin miratuar në maj të vitit 2017 nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Gjersa, me vendimin nr. 103/2017 datë 10.07.2017 është formuar grupi punues për hartimin e tri ligjeve bazike të Reformës së Administratës Publike. Pra, Qeveria dhe Kuvendi kanë pasur në dispozicion një (1) vit që t'i miratojnë, për fat të keq ka kaluar edhe viti i dytë (2) dhe ato janë miratuar vetëm në parim në tetor të vitit 2018.

Për sa i përket masës që ka të bëjë me Divizionin Fiskal të Gjykatës Themelore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka kërkuar nga Programi i USAID-it, i cili mbështet fuqizimin e sektorit të drejtësisë, që të kryejë një vlerësim në lidhje me zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura (backlog). Sipas rekomandimeve të dala nga hulumtimi, në Departamentin Administrativ-Divizioni Fiskal është dashur

⁹ Ligji Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Burimi për informata shtesë: <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18336>

të caktohen dy (2) gjyqtarë shtesë. Në korrik të vitit 2017 presidenti i Republikës së Kosovës ka dekretuar 52 gjyqtarë të rinj. Shtatëmbëdhjetë gjyqtarë të rinj janë caktuar nga KGJK-ja në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Gjyqtarët e rinj kanë përfunduar trajnimin fillestar me datë 29 tetor 2018 dhe janë shpërndarë sipas nevojave në departamente përkatëse nga Kryetarët e Gjykatave. Për më shumë, në Gjykatën Themelore të Prishtinës janë rekrutuar katër (4) këshilltar profesional për të mbështetur Divizionin Fiskal. Mbasi KGJK-ja së bashku me Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë kanë paraparë të caktohen 2 gjyqtarë shtesë në Divizionin Fiskal (dy gjyqtar në Departamentin Administrativ), ndërsa Departamenti Ekonomik është fuqizuar me staf shtesë duke caktuar një (1) gjyqtar të ri. Si rezultat, kjo masë konsiderohet e plotësuar në tërësi.

Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve

Shtylla e dytë është e ndarë në pesë kategori kryesore: Promovimi i investimeve të Huaja Direkte, Përmirësimi i Mjedisit Afarist, Statistikat, si dhe Agjenda e Interkonektivitetit dhe Energjia. Masat e parapara në kategorinë Promovimi i Investimeve të huaja direkte janë: Ristrukturimi i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë – KIESA; Miratimi i after-care programit dhe shërbimeve për investorët. Në kategorinë Përmirësimi i mjedisit afarist masat e parapara janë: Miratimi i Ligjit për Raportim Financiar; Kontabilitet dhe Auditim; Përditësimi i regjistrit qendror për leje dhe licenca; Miratimi i Ligjit për Inspektive; Miratimi i legjislacionit sekondar për ndihmë shtetërore dhe funksionalizimi i Komisionit dhe Departamentit për Ndihmë Shtetërore; Zbatimi i planit të veprimit për të luftuar ekonominë joformale; Miratimi i pakos ligjore për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë, si dhe funksionalizimi i katër laboratorëve të metrologjisë; dhe Zbatimi i prokurimit elektronik në prokurimet e centralizuara. Në kategorinë Statistikat masa e paraparë është Zhvillimi i statistikave sektoriale të biznesit, energjisë dhe atyre sociale. Në kategorinë Agjenda e Interkonektivitetit masa e paraparë është Zbatimi i të gjitha “masave të buta” në kuadër të agjendës së inter-konektivitetit. Në kategorinë Energjia masa e paraparë është Rritja e sigurisë së energjisë dhe miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026.

Për më shumë, masa e parë apo restrukturimi i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka rezultuar pas një rekomandimi të dhënë nga një projekt i BE-së, në vitin 2016, i titulluar “Rritja e Konkurrueshmërisë dhe Promovimi i Eksportit (ICEP)”. Konkretisht, kjo masë ishte paraparë të përfundojë në TM3 të 2017–ës, mirëpo draft-rregullorja për organizimin e brendshëm të MTI-së dhe vendimi për themelimin e Bordit Këshillues të KIESA-së edhe në fund të 2018–ës nuk është miratuar. Gjithashtu, miratimi i after-care programit dhe shërbimeve apo masa e dytë për investorët varet nga restrukturimi i KIESA-së. Për këtë, këto dy masa vazhdojnë të mbesin të paplotësuara.

Pastaj, Ligji për Raportim Financiar, Kontabilitet dhe Auditim ishte paraparë të miratohej në TM1 të 2017-ës, mirëpo kjo masë ka arritur të miratohet vetëm në TM2 të 2018-ës, saktësisht në Prill të vitit 2018.

Regjistri Qendror për leje dhe licenca ishte paraparë të përditësohet nga ERA mirëpo formularët nuk janë qashtëm në tri gjuhë. Andaj, kjo masë konsiderohet pjesërisht e plotësuar pasi që vetëm regjistri është përkthyer në shqip, anglisht dhe serbisht ndërsa formularët nuk janë të publikuar online në asnjërën gjuhë. Ndërkaq, veprimi i dytë është konsideruar si i plotësuar, meqenëse ngjarjet promovuese janë organizuar në tremujorin e katërt përmes një video-spoti i cili është transmetuar për 30 ditë në RTK.

Sa i përket Ligjit për Inspektime apo masa e pestë, konsiderohet si pjesërisht e plotësuar. Veprimi i parë është i plotësuar sepse koncepti dokumenti është miratuar në tremujorin e parë. Veprimet tjera janë konsideruar të paplotësuara meqenëse Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria dhe Kuvendi kanë pasur kohë t'i përfundojnë këto obligime deri në fund të shtatorit 2018, por nuk i kanë kryer.

Miratimi i legjislacionit sekondar për ndihmë shtetërore dhe funksionalizimi i Komisionit dhe Departamentit për Ndhmë Shtetërore është masa e gjashtë dhe konsiderohet si pjesërisht e plotësuar. Konkretisht, veprimi i parë është konsideruar si pjesërisht i plotësuar pasi që vetëm një nga rregulloret e parapara është miratuar¹⁰, ndërsa tjetra ende jo si pasojë e mos krijimit të Komisionit për Ndhmë Shtetërore. Pastaj, veprimi i dytë është i plotësuar meqenëse Departamenti për Ndhmë Shtetërore (DNSH-ja) është funksionalizuar brenda afatit të ri. Ndërkaq, veprimi i tretë është pjesërisht i plotësuar, meqenëse komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisionin për Ndhmë Shtetërore (KNSH) ka përgatitur raportin për rekomandim, por kandidatët ende nuk janë votuar nga deputetët e Kuvendit. .

Zbatimi i planit të veprimit për të luftuar ekonominë joformale është masa shtatë dhe pas plotësimit të veprimit të fundit konsiderohet si e plotësuar. Veprimi i mbetur ishte fuqizimi ndër-institucional; ky aktivitet nuk është ndalur pasi që ka filluar para përfundimit të tremujorit të tretë dhe pritet të vazhdojë njëjtë. Ndërsa, veprimet tjera kanë përfunduar brenda afateve të parapara dhe vazhdojnë të përditësohen.

Miratimi i pakos ligjore për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë, si dhe funksionalizimi i katër laboratorëve të metrologjisë është masa e tetë dhe konsiderohet si një masë pjesërisht e plotësuar. Konkretisht, veprimet që nuk janë finalizuar ende janë: Organizimi i 10 punëtorëve për informim të bizneseve dhe promovim të uebfaqes; Organizimi i 30 moduleve për zhvillim të kapaciteteve njerëzore sa i përket infrastrukturës dhe standardeve të cilësisë; Themelimi dhe funksionalizimi i pikës së vetme të kontaktit për shërbime.

Ndërsa, zbatimi i prokurimit elektronik në prokurimet e centralizuara apo masa e nëntë konsiderohet si masë e plotësuar, meqenëse veprimi për zbatimin e prokurimit elektronik është realizuar dhe ne kemi monitoruar implementimin e këtij procesi gjatë tërë vitit 2018.

Masa 10 apo Zhvillimi i statistikave sektoriale të biznesit, energjisë dhe atyre sociale është plotësuar ngaqë ASK vazhdimisht publikon statistikën e parapara duke përsheptuar kohën e publikimit si dhe duke përmirësuar metodologjinë. Katër veprimet e para janë të plotësuara me rregull brenda afateve, ndërsa veprimi i pestë ka të bëjë me statistika që publikohen në baza tremujore, vjetore, apo më të gjata dhe disa janë paraparë të publikohen në vitin 2020 për shkak të burimeve financiare dhe njerëzore.

Zbatimi i të gjitha “masave të buta” në kuadër të agjendës së inter-konvektivitetit apo masa 11 konsiderohet pjesërisht e plotësuar. Saktësisht, veprimi i parë për legjislacionin primar dhe veprimi i pestë për harmonizim të Kodit të Rrjetit me ENTSO-E janë plotësuar.¹¹ Mirëpo, dy veprime për tregun e përbashkët energjetik me Shqipërinë janë konsideruar si pjesërisht të plotësuara sepse kanë treguar një progres edhe pse jo shumë pozitivë. Ndërsa, përderisa nuk ka progres rreth “Zbatimit të

¹⁰ Rregullore (Qrk) Nr.19/2018 për Procedurat dhe Format e Njoftimit për Ndhmën Shtetërore. Burimi për informata shitesë: <https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/C6423C79-3933-4F7F-BOA3-AEFE0B44D0A3.pdf>

Marrëveshjes ndërmjet KOSTT-EMS” ky veprim ngelët i paplotësuar, përkundër faktit që KOSTT ka tentuar të zgjidhë kontestet me EMS-në e Serbisë. Sa i përket, Rritjes së e sigurisë të energjisë dhe miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026¹², tri nga pesë veprimet e parapara për plotësimin e kësaj mase në tërësi kanë përfunduar gjatë vitit 2018, andaj ato konsiderohen si të plotësuara. Ndërsa, dy veprimet e fundit konsiderohen pjesërisht të plotësuara, përkatësisht Plani i Rishikuar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë nuk është miratuar në kohë dhe Ligji për Eficiencë të Energjisë është miratuar bashkë me bordin për fondin e energjisë, por ky i fundit ende nuk është funksional përkundër që afatet e parapara kanë kaluar. Si rezultat, masa konsiderohet pjesërisht e plotësuar.

Punësimi dhe Arsimi

Shtylla e tretë është e ndarë në dy kategori kryesore, ajo e Punësimit dhe e Arsimit. Masat e parapara në kategorinë e Punësimit janë: Përmirësimi i mundësive të punësimit, me fokus punësimin e të rinjve dhe grave; Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015-2020 dhe miratimi i Planit të Veprimit 2017-2018 për zbatimin e strategjisë. Ndërsa, në kategorinë e Arsimit masat e parapara janë: Përmirësimi i cilësisë së arsimit nëpërmjet masave legjislative; Miratimi i legjislacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit; Përmirësimi i cilësisë në arsim; Përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë.

Konkretisht, përmirësimi i mundësive të punësimit, me fokus tek të rinjtë dhe gratë apo masa e parë ka gjithsej dy veprime dhe konsiderohet si masë e plotësuar. Dy veprimet e fundit: Zbatimi i Planit të Veprimit për Punësim dhe Politikën Sociale si dhe Punësimin e të rinjve u plotësuan në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2018.

Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015-2020¹³ dhe miratimi i Planit të Veprimit 2017-2018 për zbatimin e strategjisë¹⁴ konsiderohen si masa të plotësuara. Sa i përket kriterëve të parapara, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka plotësuar në përpikëri të gjitha kriteret e parapara në agjendë.

Për më tepër, përmirësimi i cilësisë së arsimit nëpërmjet masave legjislative apo masa e tretë, konsiderohet si masë pjesërisht e plotësuar. Konkretisht, nga tre veprimet e identifikuara, një është plotësuar, një është pjesërisht e plotësuar dhe tjetra mbetet e pa plotësuar. Ndërsa, miratimi i pakos ligjore mbetet e pa plotësuar, ndërsa ndërtimi i çerdheve publike të reja, është në proces e sipër.

Miratimi i legjislacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit apo masa e katërt, konsiderohet si masë pjesërisht e plotësuar. Gjithashtu edhe kjo masë ka gjithsej tre veprime, prej të cilave një është plotësuar, një është pjesërisht e plotësuar dhe tjetra mbetet e pa plotësuar. Për më tepër, miratimi i Projektligjit për Arsimin e Lartë si dhe ndarja e buxhetit për Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) e cila ka një deficit prej 44 milionë Euro, vazhdon të jetë sfiduese për institucionet përgjegjëse.

¹²Miratimi i Strategjisë së Energjisë. Burimi për informata shtesë: <http://mzhe-ks.net/sq/lajmet/kuvendi-i-kosoves-miratoi-strategjine-e-energjise-2017-2026>

¹³ Lansimi i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015-2020 nga MPMS-ja. Burimi për informata shtesë: <https://mpms.rks-gov.net/mpms-lanson-strategjine-sektoriale-2018-2022-dhe-planin-e-veprimit-per-punesimin-e-te-rinjve/uncategorized-sq/>

¹⁴ Miratimi nga Qeveria (Plani i Veprimit). Burimi për informata shtesë: <https://mpms.rks-gov.net/miratohet-ne-qeveri-plani-per-punesimin-e-te-rinjve/uncategorized-sq/>

Më tutje, përmirësimi i cilësisë në arsim apo masa e pestë, konsiderohet si pjesërisht e plotësuar. Saktësisht, nga shtatë veprimet e identifikuar, katër janë të plotësuara në tërësi, dy janë pjesërisht dhe një mbetet e pa plotësuar. Megjithatë, për shkak të sfidave të shumta, nuk do të ketë themelimin e Agjencionit për Kurrikulë, Standarde dhe Veprim, por do të fuqizohet divizioni për standarde vlerësim dhe monitorim. Si rrjedhojë, me rekomandim të BE-së, ky veprim do të largohet nga lista e kritereve.

Përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë apo masa e gjashtë konsiderohet si pjesërisht e plotësuar. Realisht, ngecja më e madhe në shtyllën e tretë u vërejt në këtë masë sepse nga gjithsej pesë veprime vetëm një është plotësuar. Ndërsa, pjesa tjetër është e ndërlidhur me implementimin dhe krijimin e programeve të ndryshme të kurrikulave bërthamë të AAP-së të cilat ende mbeten të pa plotësuara. Për më tepër, veprimet e pa plotësuara përfshijnë: Hartimin e kurrikulave bërthamë për AAP-së dhe fillimin e fazës së pilotimit; Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së; dhe Zgjerimi dhe përfshirja në programet studimore.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Agjenda për Reforma Evropiane po përmbyllë vitin e tretë të mos plotësimit edhe pse synimi i saj ishte përshtetimi i procesit të implementimit të PKZMSA-së. Për fat të keq, kjo nuk është duke ndodhur, andaj edhe lehtë mund të thuhet se implementimi i kësaj agjende ka qenë një ngecje e papranueshme për vendin tonë.

Qeveria dhe Kuvendi vazhdojnë të mos e kenë bashkëpunimin e duhur dhe të nevojshëm për shtyrjen tutje të këtij procesi. Paraprakisht, nga opozita gjatë viteve 2016-2017 kritikohet qeveria për dështimin e implementimit të kësaj agjende. Pastaj, me ardhjen e Qeverisë së re (opozita e lartpërmendur) shpresat ishin që të kishte përshtetimi të procesit, mirëpo asgjë nuk ndodhi. Realisht, interesi rreth këtij procesi vetëm se ra më shumë edhe pse fillimet ishin shpresëdhënëse. Ajo që mund të thuhet nga kjo, është se institucionet përgjegjëse vazhdojnë të kenë një bashkëpunim të pamjaftueshëm. Me saktë, komunikimi dhe vullneti i tyre të bashkëpunojnë rreth shtyrjes së këtij procesi tutje është duke shkaktuar ngecje. Kjo pasiqë, për të pasur rezultate pozitive, qeveria duhet të ketë përkushtimin e nevojshëm për realizimin e të gjitha reformave të domosdoshme dhe vendimtare.

Megjithatë, ne sygjerojmë që:

- ✓ Gjendja do të mund përmirësohet me daljen e iniciativave të reja në ERA2, për përshtetimin e këtij procesi dhe monitorimin e punës së bërë për miratimin dhe implementimin e të gjitha masave të planifikuara. Një nga mënyrat do të ishte që institucionet përgjegjëse për realizimin e reformave të kenë plane bashkëpunimi ndërmjet vete me afate dhe detyra të caktuara. Këto plane do të mund ta kishin formatin e detyrave të ndara dhe kohës së përcaktuar për secilin institucion. Kështu, çdo orar do të respektohet dhe nuk do të kishte vonesa nga asnjëra palë, andaj si rezultat i kësaj do të dihej saktë se ku po ngecin proceset dhe të ofrohet zgjidhja.
- ✓ Gjatë hartimit të ERA2 të gjitha institucionet që do të angazhohen për implementimin e saj duhet të jenë realiste në detyrat që marrin përsipër, pasi që ato janë më mirë të informuara rreth detyrave

dhe përgjegjësive dhe të gjitha burimeve që kanë në dispozicion për realizimin e kërkesave që dalin nga agjenda.

Ne konsiderojmë se, ngecjet më të mëdha kanë të bëjnë me miratimin e legjislacionit në Kuvend, rreth marrëveshjeve regjionale për energjinë dhe transportin dhe në implementimin e kurrikulave të reja nëpër shkolla. Atëherë, duke u bazuar në këtë ne propozojmë zgjedhjet e mëposhtme:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës do të duhej ta bëjë një analizë të brendshme se ku qëndron arsyeja për vonesat e vazhdueshme. Pastaj, nëse analiza e parasheh, që problemi është mungesa e stafit në Kuvend, atëherë do të duhej të shqyrtohej rritja e numrit të të angazhuarve të cilët do të ishin të angazhuar si ekspert në këtë proces. Për më shumë, mungesa e vullnetit politik për përshejtimin e këtij procesi në Kuvendin e Kosovës është një nga problemet kyçe, që nënkupton se secili do të duhej të angazhohej që kjo situatë të ndryshonte dhe të përmirësohej njëkohësisht.
2. Lidhur me problemet në shtyllën e dytë, do të duhej që ERA2 të mos përfshijë masa që varen edhe nga palë tjera sepse kjo po ngadalëson procesin e realizimit të agjendës. Siç u cek edhe më sipër, marrëveshjet për energji dhe transport për shkaqe politike me vendet e rajonit po shkaktojnë ngecje tek shtylla e dytë dhe të ERA në tërësi.
3. Sa i përket kurrikulave të reja dhe implementimit të tyre nga të gjitha shkollat, MASHT-i do të duhej të kishte më shumë komisione vëzhguese dhe vizita më të shpeshta në të gjitha shkollat e vendit, qoftë qytet apo fshat. Po ashtu, nuk do të duhej që politika e jashtme me vendet fqinje të ndikonte në sistemin arsimor. Realisht, shkollimi dhe ligjërimi do të duhej të bëhej me kriteret dhe rregullat e Republikës së Kosovës, realisht me kurrikulat që MASHT-i aprovon për të gjitha shkollat e vendit. Andaj, edhe kjo do të duhej të merrej parasysh nëse mendohet që kjo shtyllë të tregoj përmirësim në të ardhmen.

Aneksi 1. MATRICA E AGJENDËS PËR REFORMA EVROPIANE 2018

QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT

I. SUNDIMI I LIGJIT

MASA	VEPRIMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PERIUDHA	2018
1	Miratimi i legjislacionit duke e bërë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik, përkatësisht të akuzuarve dhe të dënuarve për korrupsion.	1.1) Miratimi i koncept dokumentit për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion	TM4 2017 - TM3 2018	P
		1.2) Miratimi i Kodit Penal të Kosovës;		P
		1.3) Miratimi i Kodit Penal të Kosovës;		P
		1.4) Kodin e Procedurës Penale;		PJ

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

1.1) Me datë 15.11.2017 kryeministri ka marrë vendimin për aprovimin e Koncept Dokumentit për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion.

1.2/1.3) Qeveria e Kosovës ka miratuar projekt Kodin e ri Penal të Kosovës me datë 13 Prill 2018. Sipas ministrit të drejtësisë, për hartimin e Kodit të ri janë bazuar në tri parime themelore: përcaktimin e qartë për sundim të mirëfilltë të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; fleksibilitet më i madh në punën e organeve të pavarura të zbatimit të ligjit; dhe mbrojtje, promovim dhe avancim të nocionit të drejtave të njeriut. Janë ndryshuar nenet që nga kontrabandimi, e deri te mashtrimi dhe prodhimi i produkteve të dëmshme, si dhe ri-përcaktimin e veprave penale të korrupsionit, keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, marrjen e dhënien e ryshfetit, mashtrimin në detyrë, etj. Kodi i ri Penal, sipas ministrit Tahiri mund të hyjë në fuqi në janar të vitit 2019.

1.4) Hartimi i Kodit të Procedurës Penale është ende në proces për të cilin Ministria e Drejtësisë është duke u punuar aktualisht.

Gjendja për periudhën TM3 2018

1.3) Kjo objektivë është plotësuar nga Qeveria por Kuvendi vazhdon të shkaktoj ngecje. Kodi Penal është miratuar në lexim të parë nga Kuvendi, aktualisht është në shqyrtim në Komisionin për Legjislacion. Sa i përket Kodit Penal është përfshirë (largimi nga puna të zyrtarëve të dënuar për vepra penale të korrupsionit dhe të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, nga 1 deri në 10 vite) respektivisht neni 62 dhe neni 63 i draft Kodit Penal.

1.4) Suspendimi nga puna e zyrtarëve publik, me rastin e ngritjes së aktakuzës për vepra penale të cekura si më lartë do të përfshihet në Kodi të Procedurës Penale, i cili është në fazën finale të hartimit nga Ministria e Drejtësisë, në muajin nëntor planifikohet të dërgohet në Kuvend.

Gjendja për periudhën TM4 2018

1.3) Me datën 23.11.2018 Kuvendi ka miratuar Projekt Kodin Penal të Kosovës;

1.4) Me datën 27.12.2018 Kodi i Procedurës Penale është dërguar në Qeveri për shqyrtim dhe aprovim. Pra, ende gjendet në Qeveri.

2	Plotësimi i Ligjit për Konflikt Interesi	2.1) Pranimi i Projektligjit nga Komisioni Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	KUVENDI	TM1 2018	P
		2.2) Pranimi i Projektligjit nga Komisioni për Integritet Evropiane	KUVENDI		P
		2.3) Miratimi i Projektligjit nga Kuvendi	KUVENDI		P

Gjendja për periudhën TM3 2018

2.1) Me datë 29 Mars 2018, në mbledhjen e mbajtur Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, pas diskutimeve përkrah Projektligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Në nenin 12, pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri 3 me përmbajtjen si vijim: "Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik, përveç rasteve kur është i caktuar sipas detyrës zyrtare".

2.2) Me datë 30 Mars 2018, Komisioni për Integritet Evropiane, kryesuar nga kryetarja e Komisionit, Blerta Deliu-Kodra, shqyrtoi Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e komisioneve funksionale, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. U theksua fakti se këto dy projektligje nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohen për miratim në seancë.

2.3) Me datë 30 Mars 2018 gjatë seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga kryeparlamentari, Kadri Veseli, (dhe një pjesë e seancës është kryesuar nga nënkryetari Xhavit Haliti), deputetët shqyrtuan dhe miratuan në lexim të dytë 11 projektligje, ku në mesin e tyre u miratua edhe Projektligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

3	Plotësim - ndryshimi i Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit për të mundësuar rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe krimit të nivelit të lartë.	3.1) Pranimi i Projektligjit nga Komisioni Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	MD AKADEMIA E DREJTËSISË	TM2 2017 - TM1 2018	P
		3.2) Pranimi i Projektligjit nga Komisioni për Integritet Evropiane	KUVENDI MD / AKADEMIA E DREJTËSISË		P
		3.3) Miratimi i Projektligjit nga Kuvendi	KUVENDI MD / AKADEMIA E DREJTËSISË		P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

Me datë 15 Nëntor 2017, Qeveria e Kosovës ka miratuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurorin e shtetit.

3.1) Me datë 29 Mars 2018, në mbledhjen e mbajtur Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, pas diskutimeve përkrah Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe

plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034. Komisioni nuk përkrahu amendamentin e deputetes Albulena Haxhiu, për të shtuar një nen të ri në këtë projektligj "për kryerjen e përgjegjësive të tyre, çdo prokuror duhet të ketë nga një bashkëpunëtor profesional". Ndonëse të gjithë anëtarët e komisionit në parim shprehën miratim për këtë propozim, ata shtuan se duhet bërë një analizë buxhetore më e hollësishme.

3.2) Me datë 30 Mars 2018, Komisioni për Integritet Evropian, kryesuar nga kryetarja e Komisionit, Blerta Deliu-Kodra, shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, me amendamentet e komisioneve funksionale, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. U theksua fakti se këto dy projektligje nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohen për miratim në seancë.

3.3) Me datë 30 Mars 2018 gjatë seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga kryeparlamentari, Kadri Veseli, (dhe një pjesë e seancës është kryesuar nga nënkryetari Xhavit Haliti), deputetët shqyrtuan dhe miratuan në lexim të dytë 11 projektligje, ku në mesin e tyre u miratua edhe Projektligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit.

4	Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë	4.1) Hartimi i Projektligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë	MD	TM1 2018	P
		4.2) Miratimi i Projektligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë nga Qeveria	MD		P
		4.3) Miratimi i Projektligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë nga Kuvendi.	KUVENDI MD		P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

4.1/ 4.2) Projektligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve është miratuar në Qeveri me 01.02.2018.

4.3) Projektligji me datë 03 Maj 2018 është miratuar në parim dhe Kuvendi angazhoi për shqyrtim këto komisione: Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për Integritet Evropian; dhe Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim; Komisionet në fjalë pritet të dërgojnë rekomandimet e tyre brenda afatit kohor të paraparë në Rregulloren e Kuvendit.

Gjendja për periudhën TM3 2018

Projektligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë është miratuar në lexim të parë në Kuvend me datën 3 Maj 2018, aktualisht është në shqyrtim në Komisionin për Legjislacion.

Gjendja për periudhën TM4 2018

Me datën 23.11.2018 është miratuar nga Kuvendi Projektligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë

II. REFORMA ZGJEDHORE

MASA	VEPRIMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PERIUDHA	2018	
5	Përgatitja e pakos ligjore për reformën zgjedhore, duke përfshirë rekomandimet e misionit vëzhgues të BE-së dhe kërkesa për opinion nga komisioni i Venedikut.	Miratohet pakoja për reformën zgjedhore, duke përfshirë rekomandimet e misionit vëzhgues të BE-së dhe kërkesa për opinion nga komisioni i Venedikut.	KUVENDI	TM3 2018	PA

Gjendja për vitin 2018

Nuk ka asnjë zhvillim konkret për sa i përket Reformës Zgjedhore.

6	Përgatitja e Ligjit për financimin e partive politike dhe kërkesa për opinion nga komisioni i Venedikut.	6.1) Hartimi i draftit të Projektligjit për financimin e partive politike	ZKM	TM3 2018	P
		6.2) Konsultimet publike, të kryera.	ZKM		P
		6.3) Shqyrtimi i Projektligjit nga Komisioni i Venedikut.	ZKM		P
		6.4) Miratimi i Projektligjit nga Qeveria.	ZKM		PJ
		6.5) Miratimi i Projektligjit nga Kuvendi.	KUVENDI ZKM		PA

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

6.1) Zyra Ligjore e ZKM-së, ka hartuar draftin e Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike dhe ka organizuar takime publike me përfaqësues të subjekteve politike dhe OJQ. Projektligji ka kaluar fazën e konsultimit paraprak sipas nenit 7 të Rregullores 09/ 2011 të Punës së Qeverisë.

6.2) Projektligji ka kaluar fazën e konsultimit paraprak sipas nenit 7 të Rregullores 09/ 2011 të Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe Rregullores (QRK) Nr.05 / 2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik.

6.3) Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike me datë 16 prill 2018 është dërguar në Komisionin e Venedikut për shqyrtim. Me datë 22- 23 qershor 2018 përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës kanë marrë pjesë në sesionin plenar të 115-të, të Komisionit të Venedikut, ku kanë prezantuar Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike.

6.4/6.5) Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike është paraparë të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 28.09.2018.

Gjendja për periudhën TM3 2018

Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike gjendet në Ministrinë e Integritimit Evropian dhe Ministrinë e Financave, nga të cilat pritet t'i dërgojnë opinionet e tyre përkatëse (opinionin ligjor nga MIE dhe deklaratën e vlerësimit financiar nga MF). Pastaj, Zyra Ligjore menjëherë do ta procedoj këtë Projektligj për shqyrtim dhe aprovim nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjendja për periudhën TM4 2018

Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike është paraparë të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe me 30 Tetor 2018 është proceduar në Kuvend, mirëpo edhe në fund të TM4 2018 nuk është miratuar nga Kuvendi.

7	Përfundimi i auditimit të financave të partive politike; Publikimi i raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj.	7.1) Përfundimi i auditimit të financave të partive politike për vitin 2017.	KUVENDI	TM2 2018	PA
		7.2) Publikimi i raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj.	KQZ	TM3 2018	PA

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

7.1) Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike me datë 19 janar 2018 ka aprovuar kërkesën që 10 auditorë të merren me auditimin e raporteve financiare për vitin 2017. Mirëpo, si rezultat i mungesës së operatoreve ekonomik procesi qëndron ende në fazën e përzgjedhjes. Komisioni ka dërguar në ri-tenderim për herën e tretë auditimin e raporteve financiare, pasi që procesi i përzgjedhjes ka dështuar 2 herë radhazi. Kërkesa është publike mirëpo edhe pas takimeve konsultative me operatorët ekonomik nuk ka pasur kërkesa të dërguara nga operatorët ekonomik. Afati i fundit për dërgimin e ofertave nga operatorët ekonomik është data 15 gusht 2018, mirëpo komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike do t'i duhet ta zgjasë këtë afat nëse nuk pranon oferta nga operatorët ekonomik.

7.2) Publikimi i raporteve financiare të partive politike, siç parashihet në ligj, nuk mund të bëhet nëse ato nuk janë të audituara. Mirëpo, përderisa afati për publikim mbetet TM3 2018 ky veprim nuk mund të konsiderohet e paplotësuar por në realizim e sipër sepse ka ende kohë që kjo objektive të realizohet.

Gjendja për periudhën TM3 2018

Për sa i përket auditimit dhe publikimit të raporteve financiare nuk ka ndonjë zhvillim nga raporti i fundit.

Gjendja për periudhën TM4 2018

Kërkesa është publike mirëpo edhe pas takimeve konsultative me operatorët ekonomik nuk ka pasur kërkesa të dërguara nga operatorët ekonomik. Kjo gjendje ka mbetur gjatë tërë vitit 2018 dhe në përfundim të tij nuk ka ndonjë ndryshim.

III. REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

MASA	VEPRIMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PERIUDHA	2018
8	Zbatimi i Planit për racionalizimin e agjencive të pavarura dhe organeve qendrore në kuadër të Qeverisë	8.1) Realizimi i analizës e cila ka për qëllim për racionalizimin e agjencive të pavarura dhe organeve qendrore në kuadër të Qeverisë	ZKM	P
		8.2) Krijimi i grupit punues i cili duhet të hartoj Planin e Veprimit për racionalizimin e agjencive të pavarura dhe organeve qendrore në kuadër të Qeverisë	MAP	P
		8.3) Hartimi i planit për racionalizimin e agjencive të pavarura dhe organeve qendrore në kuadër të Qeverisë	MAP	P

		8.4) Miratimi i planit për racionalizimin e agjencive te pavarura dhe organeve qendrore ne kuadër të Qeverise	MAP		PJ
--	--	--	------------	--	----

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

8.1) Zyra e Kryeministrit ka përfunduar analizën e cila ka për qëllim racionalizimin e agjencive.

8.2) MAP ka krijuar grupin punues në lidhje me këtë pikë, i cili ka hartuar një PV me 4 runde të reformave. Rundi i parë janë agjencitë që janë në Kuvend, rundi i dytë dhe e tretë kanë të bëjnë me agjencitë që kanë kompetenca ekzekutive dhe janë në Qeveri, ndërsa i katërti ka të bëjë me agjencitë që janë ekzekutive po që janë në Kuvend, por që sipas standardeve evropiane duhet të jenë në Qeveri.

8.3/8.4) Pritet miratimi i draft-planit e veprimit për racionalizimin e Agjencive nga Qeveria e Kosovës gjatë muajit korrik.

Gjendja për periudhën TM3 2018

8.4) Ministria e Administratës Publike ka themeluar Sekretariatit për Racionalizmin e Agjencive. Sekretariati është një trup profesional i cili do të mbështet Këshillin e Ministrave për RAP në procesin e racionalizimit të agjencive. Sekretariati ka hartuar Draft- Planin e Veprimit ku janë pasqyruar të gjitha agjencitë që janë identifikuar me herët nga analiza. Pastaj, me 20 korrik 2018 janë përmbjllur konsultimet publike për “Draft koncept-dokument për valën e parë të racionalizimit dhe vendosjes së vijave të llogaridhënies për agjencitë të cilat funksionojnë në Kuvendin e Kosovës”. Me 31 korrik 2018 Sekretariati për Racionalizimin e Agjencive ka mbajtur takim për shqyrtimin e rekomandimeve dhe komenteve për koncept-dokumentin. Në këtë takim pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe zyrtarëve nga Zyra e BE-së.

Gjendja për periudhën TM4 2018

Plani për racionalizimin e agjencive të pavarura dhe organeve qendrore në kuadër të Qeverisë dhe Koncept Dokumentit për valën të racionalizimit dhe vendosjes së vijave të llogaridhënies për agjencitë të cilat funksionojnë ne Kuvendin e Kosovë, janë hartuar dhe dërguar për konsultime paraprake.

9	Sigurimi i një procesi te përzgjedhjes që është transparent, i bazuar në merita dhe jo-politik, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe në kompani publike;	9.1) Përcjellja e i CV-ve të kandidatëve në listë të ngushtë;	ZKM	TM3 2018	P
		9.2) Publikimi i CV-ve të kandidatëve në listë të ngushtë nga Njësia për Politika dhe Monitorimin e NP-së	ZKM		PA
		9.3) Përfshirja e shoqërisë civile në komisionet përzgjedhëse, në bazë të një përzgjedhje transparente dhe të hapur të përfaqësuesve të shoqërisë civile;	ZKM		P
		9.4) Fuqizimi dhe qartësimi i kriterëve minimale për kandidatët përmes përfshirjes së kriterëve të ngjashme me nenin 17 paragrafi 2 i ligjit mbi NP-të, për shembull, në ndryshimet në ligjin mbi konfliktin e interesit, duke i bërë kështu të aplikueshme në të gjitha agjencitë e pavarura dhe organet rregullative.	ZKM		P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

9.1) Sekretariati Koordinues i Qeverise të gjitha CV-it e kandidatëve të emëruar në borde të ndërmarrjeve publike” Trepça Sh.A, Telekomit i Kosovës, i ka përcjell te Njësia për Politika dhe Monitorimin e NP-së /MZHE për t’u publikuar.

9.2) Njësia për Politika dhe Monitorimin e NP-së në MZHE nuk i ka publikuar ende CV, e listës së ngushtë apo të personave të emëruar, për shkak të problemeve teknike.

9.3) Me qëllim të rritjes së transparencës së punës së Qeverisë duke u bazuar në opinionin e Zyrës Ligjore të ZKM- me shkresën e Zyrës së Kryeministrit nr. 129/3 të datës 06 mars 2017 , Shoqëria Civile është e përfshirë në të gjitha komisionet rekomanduese për zgjedhjen e bordeve të ndërmarrjeve publike

9.4) Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me datën 24 shkurt 2017, ka nxjerr Rregullat mbi Identifikimin e Kandidatëve për drejtorë të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore dhe Metodologjinë e Vlerësimit. Kjo objektivë konsiderohet e plotësuar.

Gjendja për periudhën TM3 2018

9.2) Nga data 22 gusht deri me 24 shtator 2018 është shpallur konkursi për katërbëdhjetë (14) Borde të Ndërmarrjeve Publike. Pas përfundimit të gjithë procesit të konkurrimit të hapur dhe transparent si dhe pas rekomandimit të Komisioneve Rekomanduese Qeveria e Republikës së Kosovës do ti emëroi Bordet Drejtuese të katërbëdhjetë(14) Ndërmarrjeve Publike Qendrore. Sekretariati Koordinues i Qeveris pas përfundimit të procesit të gjitha CV-it e kandidatëve të emëruar në borde të ndërmarrjeve publike të bashkangjitur me Vendimet e Qeveris do t'ia përcjell Njesisë për Politika dhe Monitorim të NP-së /MZHE.

Pritet të shihet nëse kësaj radhe do të publikohen CV-të nga njësia për Politika dhe Monitorimin e NP-së në MZHE.

Gjendja për periudhën TM4 2018

CV- të edhe në fund të vitit nuk janë publikuar nga institucionet përgjegjëse. Kjo masë vazhdon të jetë pjesërisht e plotësuar.

10	Miratimi i pakos ligjore për reformë të Administratës Publike	10.1) Miratimin e Ligjit për Organizimin e Administratës Publike (ligj i ri);	MAP KUVENDI	TM2 2018	PJ
		10.2) Miratimi i Ligjit për Pagat nga Buxheti (ligj i ri);	MAP KUVENDI		PJ
		10.3) Miratimi i Ligjit për Shërbimin Civil (ligj i ri);	MAP KUVENDI		PJ

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

10.1) Hartimi i draft-ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Publike dhe agjencive të pavarura është në fazën e shqyrtimit dhe analizës së komenteve të pranuar nga institucionet e ndryshme gjatë fazës së konsultimeve publike dhe pastaj do të dërgohen për vlerësim financiar në MF dhe për opinion dhe deklaratën e pajtueshmërisë në MIE.

10.2) Hartimi i draft-ligjit për Zyrtarët Publik është në fazën e shqyrtimit dhe analizës së komenteve të pranuar nga institucionet e ndryshme gjatë fazës së konsultimeve publike dhe pastaj do të dërgohet për vlerësim financiar në MF dhe për opinion dhe deklaratën e pajtueshmërisë në MIE.

10.3) Hartimi i draft-ligjit për Pagat është në fazën e shqyrtimit dhe analizës së komenteve të pranuar nga institucionet e ndryshme gjatë fazës së konsultimeve publike dhe pastaj të dërgohen për vlerësim financiar në MF dhe për opinion dhe deklaratën e pajtueshmërisë në MIE.

Gjendja për periudhën TM3 2018

Projektligjet janë aprovuar nga Qeveria dhe janë dërguar për miratim në Kuvendin e Kosovës.

Gjendja për periudhën TM4 2018

Projektligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Publike dhe agjencive të pavarura, Projektligji për Zyrtarët Publik dhe Projektligji për Pagat janë miratuar në parim nga Kuvendi i Kosovës më datë 25.10.2018.

11	Fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit Ekonomik dhe Divizionit Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës së Shkallës së Parë në Prishtinë, përfshirë në fushat e tatimit dhe doganave, me qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara	11.1) Të bëhet vlerësimi i nevojave nga KGJK për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat Themelore Ekonomike.	KGJK	TM1 2017	P
		11.2) Të ngritët numri i gjyqtarëve në Gjykatat Themelore.	KGJK		P
		11.3) Ngritja e kapaciteteve njerëzore të nevojshme.	KGJK		P
		11.4) Caktimi i gjyqtarëve në Divizionin Fiskal	KGJK		P
		11.5) Caktimi i gjyqtarëve në Departamentin Ekonomik	KGJK		P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

11.1) Në lidhje me Divizionin Fiskal në Gjykatën Themelore, KGJK ka kërkuar nga Programi i USAID-it i cili mbështet fuqizimin e sektorit të drejtësisë, që të kryejë një vlerësim në lidhje me zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura (backlog). Hulumtimi ka përfunduar dhe sipas rekomandimeve në Departamentin Administrativ-Divizioni Fiskal duhet të caktohen edhe dy (2) gjyqtarë shtesë.

11.2) Në korrik të vitit 2017 presidenti i Republikës së Kosovës ka dekretuar 52 gjyqtarë të rinj. Shtatëmbëdhjetë gjyqtarë të rinj janë caktuar nga KGJK-ja në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

11.3) Administrata e gjykatës ka rekrutuar katër (4) staf profesional për të mbështetur divizionin fiskal në mbështetje të tyre janë edhe zyrtarët ligjorë.

11.4) Gjyqtarët e rinj nuk do të jenë në dispozicion për trajtimin e rasteve gjyqësore deri në përfundimin e trajnimit fillestar në Akademinë e Drejtësisë. Vlerësohet se gjyqtarët do të jenë në dispozicion në gusht apo shtator të këtij viti. Pas përfundimit të trajnimit KGJK në bashkëpunim me Kryetaren e Gjykatës Themelore të Prishtinës, janë zotuar të caktojnë gjyqtarë shtesë në Divizionin Fiskal.

11.5) Sa i përket Departamentit Ekonomik është caktuar edhe një gjyqtar shtesë dhe vlerësohet se numri i gjyqtarëve në këtë departament është i mjaftueshëm.

Gjendja për periudhën TM3 2018

11.4) Gjyqtarët e rinj do të përfundojnë trajnimin fillestar me datë 29 tetor 2018 dhe si këtij divizioni do të shtohet edhe një gjyqtar i ri.

Gjendja për periudhën TM4 2018

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë rekrutuar katër (4) këshilltar profesional për të mbështetur Divizionin Fiskal. Po ashtu, në mbështetje të tyre janë edhe zyrtar ligjorë. KGJK së bashku me Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë, janë zotuar të caktojnë 2 gjyqtarë shtesë në Divizionin Fiskal (dy gjyqtar në Departamentin Administrativ). Ndërsa, Departamenti Ekonomik është fuqizuar me staf shtesë duke caktuar edhe një (1) gjyqtar.

Tabela 2. Masat dhe veprimet për shtyllën Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit.

KONKURRUESHMËRIA DHE KLIMA E INVESTIMEVE

PROMOVIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

MASA	VEPRIMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PERIUDHA	2018
1	Ristrukturimi i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - KIESA	MTI KIESA	TM1 2018	PA
	1.5) Ristrukturimi i KIESA për t'i mundësuar që të përmbush me efikasitet përgjegjësitë e saj dhe të zbatojë prioritetet, ndarjen e burimeve të duhura dhe rekrutimin e punonjësve të kualifikuar	MTI KIESA	TM1 2018	PA
	1.6) Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të KIESA për dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve	MTI KIESA	TM1 2018	PA
	1.7) Themelimi i Bordit Këshillues në kuadër të KIESA me pjesëmarrjen e komunitetit biznesor dhe përfshirjen e fuqishme të Zyrës së Kryeministrit	MTI KIESA	TM1 2018	PA

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

1.1/1.2) Ristrukturimi i KIESA-s dhe masave përcjellëse fillimisht është paraparë të përfundojë në tremujorin e tretë të vitit 2017. Në vitin 2016, përmes një projekti të financuar nga BE, i quajtur “Rritja e konkurrueshmërisë dhe promovimi i eksportit” (ICEP) është bërë një analizë e detajuar për agjencinë e investimeve të Kosovës krahas agjencive në rajon në të cilin është rekomanduar struktura e re e KIESA-s. Në këtë analizë janë ofruar edhe rekomandime për përpilimin e shërbimeve dhe programeve të reja, por që të dyja kanë ngecur ngaqë Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani nuk ka marrë vendim për ta finalizuar ristrukturimin e agjencisë.

Me vendimin e Kryeministrit Haradinaj për përfundimin e prioriteteve të Agjendës për Reforma Evropiane (ARE) në 2018, ristrukturimi është paraparë të përfundojë më 30 mars, por sipas raportit të fundit të Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE), ristrukturimi mbetet i pa realizuar. Si rrjedhojë, mbetet që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) t'i propozojë Qeverisë strukturën organizative të KIESA-s, e cila është paraparë të bëhet bashkë me Rregulloren për organizimin e brendshëm të MTI-së ashtu si edhe është dakorduar në takimin e Këshillit Ministror për Integritim. Rregullorja e dërguar në Ministrinë e Administratës Publike (MAP) nga MTI nuk parasheh asgjë për KIESA, por vetëm për ndryshimet në Departamentin e Turizmit.

1.3) Sa i përket bordit këshillues, gjendja mbetet e njëjtë me vitin e kaluar, pra draft lista e anëtarëve të Ekipit të Kosovës (Team Kosova) dhe Bordit Konsultativ të KIESA-s është përgatitur dhe dërguar për miratim tek Ministri Hasani. MTI mbetet të dërgojë në Qeveri për miratim projektvendimin për themelimin e Bordit Këshillëdhënës.

Gjendja për periudhën TM3 2018

1.1/1.2/1.3) Edhe pse nuk kemi marrë përgjigje nga MTI sipas afatit të paraparë me Ligjin për Qasje në Dokumente, sipas burimeve të tjera të informimit, për shkak të shkarkimit të Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, zëvendësimit të tij me një ushtruese detyre dhe tash riemërimin e Ministrit të ri, gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht nuk ka pasur ndonjë lëvizje përpara sa i përket Ristrukturimit të Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë – KIESA.

Gjendja për periudhën TM4 2018

1.1/1.2/1.3) Edhe pse nuk kemi marrë përgjigje nga MTI sipas afatit të paraparë me Ligjin për Qasje në Dokumente as kësaj radhe, sipas raportit të Ministrisë së Integritimit Evropian të publikuar në dhjetor 2018, as deri në fund të nëntorit 2018, draft rregullorja mbi organizimin e brendshëm të MTI-së dhe vendimi për themelimin e Bordit Këshillues të KIESA-së nuk janë miratuar në qeveri. Po ashtu edhe kapaciteti i personelit të KIESA-s për zbatimin e shërbimeve dhe programeve po zbatohen në bazë të stafit aktual, por jo sipas ndryshimeve të pritura. Për këtë arsye, dhe meqenëse këto objektiva janë paraparë të përfundojnë në tremujorin e parë të 2018-ës, konsiderojmë se të gjitha veprimet për këtë masë mbesin të paplotësuara për vitin 2018.

2	Miratimi i after-care programit dhe shërbimeve për investitorët	2.1) Përgatitja dhe fillimi i zbatimit të shërbimeve dhe programeve të kujdesit pasues për investitorët	MTI	TM3 2018	PA
----------	---	--	------------	----------	-----------

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

2.1) Miratimi i after-care programit dhe shërbimeve për investitorët fillimisht është paraparë të përfundojë në tremujorin e katërt të vitit 2017. Sipas MTI-së, gjatë vitit të kaluar KIESA kishte programe ekzistuese për të ofruar shërbime pasuese (after-care) për investitorët në Kosovë përmes të cilave ka krijuar bashkëpunim të ngushtë edhe me investitorë të ri të mundshëm në Kosovë.

Megjithatë, sipas vendimit të lartcekur të Kryeministrit, miratimi i këtij programi sipas rekomandimeve nga analiza është paraparë të bëhet më 30 shtator 2018. Mirëpo pa finalizuar ristrukturimin e agjencisë, as ky program nuk mund të miratohet. Mbetet të shihet nëse do të miratohet sipas afatit të përcaktuar, pra në fund të trejmuorit pasues.

Gjendja për periudhën TM3 2018

2.1) Edhe pse nuk kemi marrë përgjigje nga MTI sipas afatit të paraparë me Ligjin për Qasje në Dokumente, sipas burimeve të tjera të informimit, kjo masë po ashtu ngec anipse është dashur që të përfundojë deri në fund të shtatorit të këtij viti. Por meqë ka ngecur ristrukturimi, kjo si masë pasuese, ka ngecur gjithashtu në realizim.

Gjendja për periudhën TM4 2018

2.1) Duke ritheksuar se nuk kemi marrë përgjigje nga MTI as kësaj radhe, sipas raportit të Ministrisë së Integritimit Evropian të publikuar në dhjetor 2018, as kjo masë sigurisht që nuk është plotësuar pasi që ndërlidhet me masën paraprake, pra është veprim pasues i saj. Meqenëse kjo masë është paraparë të finalizohet deri në fund të tremujorit të tretë 2018 dhe nuk është plotësuar as deri në fund të tremujorit të katërt, vlerësojmë se kjo masë është e paplotësuar deri në fund të vitit 2018.

II. PËRMIRËSIMI I MJEDISIT AFARIST

MASA	VEPRIMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PERIUDHA	2018
3	Miratimi i Ligjit për Raportim Financiar, Kontabilitet dhe Auditim	KUVENDI	TM1 2018	P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

3.1) Me qëllim të harmonizimit të legjislacionit vendor me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe njëherit adresimin më adekuat dhe të avancuar të fushës së raportimit financiar dhe auditimit, ligji për Raportim Financiar, Kontabilitet dhe Auditim është përpiluar që të përkohë me direktivat e Bashkimit Evropian mbi auditim Nr. 2014/56 dhe direktivën mbi raportimin vjetor financiar 2013/34. Projektligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim është finalizuar nga grupi punues, dhe në versionin

përfundimtar të projektligjit ka kontribuar gjithashtu Zyra Ligjore nga Zyra e Kryeministrit dhe ekspertët e UNDP-së. Sipas MF-së, projektligji adreson rekomandimet e dhëna nga raporti ROSC i Bankës Botërore (2012) mbi vëzhgimin e standardeve dhe kodeve të kontabilitetit dhe auditimit.

Projektligji është shpërndarë tek palët e interesit për komente dhe gjatë muajit nëntor 2017 janë përfunduar konsultimet publike duke përfshirë vërejtjet dhe sugjerimet e marra nga procesi i konsultimeve. Ky projektligj është miratuar nga Qeveria më 15 dhjetor 2017. Projektligji rregullon sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar të shoqërive tregtare. Gjithashtu rregullon kompetencat dhe përgjegjësit e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilist profesional, licencimin e auditorëve dhe të firmave vendore dhe të huaja të auditimit si dhe organizatat profesionale të kontabilitetit.

Ligji është parashikuar të miratohet nga Kuvendi në tremujorin e parë 2017 mirëpo është shtyrë për tremujorin e tretë 2017. Miratimi i Ligjit nga Kuvendi është bërë më 30 mars 2018. Megjithatë publikimi i ligjit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës është bërë më 19 prill 2018, pra pas afatit të paraparë me vendimin e Kryeministrit për përbushjen e objektivave të ARE në 2018. MF ka sugjeruar që ligji të hyjë në fuqi 15 ditë pas publikimit siç praktikohet në të shumtën e rasteve, por Kuvendi e ka parë si të arsyeshme që ligji të hyjë në fuqi në janar 2019.

Gjendja për periudhën TM3 2018

3.1) Ligji është miratuar në prill të vitit 2018, por do të hyjë në fuqi në janar të vitit 2019.

Gjendja për periudhën TM4 2018

3.1) Ligji është miratuar në prill të vitit 2018 dhe ka hyrë në fuqi më 1 janar 2019. Prandaj, kjo masë konsiderohet e plotësuar për vitin 2018.

4	Përditësimi i regjistrit qendror për leje dhe licenca	4.1) Formularët për leje/licenca janë dërguar për përkthim në shqip dhe anglisht ZKM	ZKM	TM2 2018	PJ
		4.2) Ngjarje promovuese për verzionin e përditësuar të këtij regjistri janë organizuar	ZKM	TM2 2018	P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

4.1) Ligji për Sistemin e Lejeve dhe Licencave nxjerr si detyrim themelimin, administrimin dhe funksionimin e Regjistrit të lejeve dhe licencave në nivelin qendror të Republikës së Kosovës. Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit me përkrahjen e projektit nga IFC- Banka Botërore, dhe pas bashkëpunimit me të gjitha ministritë dhe institucionet e pavarura, gjatë vitit 2014 – 2015 ka identifikuar rreth 480 leje, licenca, autorizime, certifikime, pëlqime, etj. Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave tani përmban informacione për 456 leje dhe licenca për qytetarët dhe bizneset, të lëshuara nga 26 institucione qendrore në 21 fusha të aktivitetit ekonomik, ku përfshihen: leje, licenca, certifikata, autorizime, pëlqime, regjistrime dhe njohje.

Në nëntor të vitit 2017 ka filluar përditësimi i këtij regjistri. Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave pas përditësimit përmban informacione për rreth 488 leje/licenca, të lëshuara nga 25 institucione qendrore në 21 fusha të aktivitetit ekonomik, ku përfshihen: leje, licenca, certifikata, autorizime etj.

Disa nga aktivitetet e ndërmarra janë:

- Rishikimi i listës së lejeve dhe licencave të identifikuara në nivel qendror
- Regjistri pas procesit të bashkëpunimit me akterë relevant përmes pyetësorit dhe duke përdorur formatin e rregullores për funksionimin e tij, tani përfshin edhe lejet dhe licencat që nuk kanë qenë pjesë e regjistrit të deritanishëm
- Ndryshimet e ndërmarra përfshijnë eliminim të lejeve/licencave ekzistuese, shtimit të lejeve/ licencave të reja, ndryshimet në tarifën/pagesën e aplikuar dhe kohën që nevojitet për marrjen e lejes/licencës, ndryshimet në dokumentacion që kërkohet për dorëzim tek autoriteti që lëshon lejen etj;

- Finalizimi i listës së azhurnuar të lejeve dhe licencave për çdo ministri/agjenci/ organizatë të pavarur
- Bërja e ndryshimeve direkt në regjistrin elektronik për lejet dhe licencat ekzistuese që kanë pasur ndryshime
- Vendosja e lejeve dhe licencave të reja në regjister elektronik sipas pyetësorit për mbledhjen e informacionit mbi lejet & licencat

Regjistri online, <https://lejelicenca.rks-gov.net>, është i përkthyer në të tri gjuhët, shqip, serbisht dhe anglisht si dhe ka informacione për të gjitha lejet, licencat dhe tarifat, mirëpo formularët në asnjërën gjuhë nuk janë të vendosura në të.

4.2) Ngjarjet për të promovuar versionin e azhurnuar të regjistrit elektronik për leje licenca varen nga agjenda e Kryeministrit dhe përfaqësuesve të Bankës Botërore, por pritet të mbahen në tremujorin e radhës.

Gjendja për periudhën TM3 2018

4.1) Përditësimi i Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave tash e tutje do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Institucionet e mandatuara për lëshimin e lejeve dhe licencave janë të informuara se janë të obliguara që të dërgojnë në Zyrën Ligjore të dhënat për lejet të reja dhe për ndryshimet në lejet ekzistuese. Mirëpo, edhe pse regjistri online është i përkthyer në të tri gjuhët ashtu siç është dashur, formularët vazhdojnë të mungojnë në të tria gjuhët për shumicën e rasteve e në disa raste ka formularë, por vetëm në shqip.

4.2) Gjatë tremujorit të tretë 2018, nuk është organizuar asnjë ngjarje promovuese për shkak të angazhimeve të ZKM-së në plotësimin e obligimeve që kanë rezultuar në përditësimin e Regjistrit për Leje dhe Licenca. Organizimi i lansimit të regjistrit dhe promovimit të tij pritet në muajt në vazhdim, por kjo varet nga IFC, konkretisht nga Drejtori Rajonal i IFC dhe Kabinetit të Kryeministrit.

Gjendja për periudhën TM4 2018

4.1) Sipas Zyrës së Kryeministrit (ZKM), përkthimi i procedurave administrative ka përfunduar në tërësi. Ndërsa, sa i përket formularëve (kërkesave) për aplikim disa prej tyre janë në dispozicion në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, por pjesa dërmuese janë vetëm në gjuhën shqipe për arsye se ato i kanë marrë të gatshme nga institucionet përkatëse ashtu siç ata i kanë në dispozicion. Meqenëse veprimi kërkon përkthimin e të gjithë formularëve në të tri gjuhët, ky veprim vlerësohet si pjesërisht i plotësuar për vitin 2018.

4.2) Zyra Ligjore e ZKM-së në bashkëpunim me IFC-në, kanë organizuar konferencën për lansimin e versionit të përditësuar i Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave më 21 nëntor 2018. Po ashtu është organizuar një fushatë vetëdijesuese përmes transmetimit të një video – spoti në Radio Televizionin e Kosovës në një periudhë prej 30 ditësh. Prandaj, ky veprim vlerësohet si i plotësuar për vitin 2018.

5	Miratimi i Ligjit për Inspektive	5.1) Miratimi i Koncept dokumentit nga Qeveria	QEVERIA	TM3 2018	P
		5.2) Ligji për inspektimet e përgjithshme i hartuar	MTI	TM3 2018	PA
		5.3) Konsultimet publike me shoqërinë civile dhe akterët tjerë relevant janë mbajtur	MTI	TM3 2018	PA
		5.4) Miratimi i Projektligjit nga Qeveria	QEVERIA	TM3 2018	PA
		5.5) Miratimi i Projektligjit nga Kuvendi	KUVENDI	TM3 2018	PA

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

5.1/5.2) Koncept dokumenti për projektligjin për Inspektimet është paraparë të përgatitet në tremujorin e tretë të 2017-ës, ndërsa procedurat përcjellëse deri tek miratimi i ligjit të finalizohen gjatë tremujorit të katërt të po këtij viti. Gjatë gjashtë mujorit të parë të 2018-ës nuk ka pas ndonjë zhvillim rreth këtij ligji. Grupi punues për koncept dokumentin është caktuar me vendimin e 22 marsit të 2017-ës të qeverisë për hartimin e koncept dokumentin. Koncept dokumenti është hartuar nga grupi ndërministror dhe është miratuar nga qeveria më 9 mars 2018.

5.3/5.4/5.5) Koncept dokumenti nuk ka dalë në konsultim publik dhe si rrjedhojë janë shtyer edhe miratimi i projektligjit nga qeveria dhe kuvendi. Megjithatë, vendimi i ri i Kryeministrit parasheh që ky ligj të miratohet deri në fund të tremujorit të tretë të 2018-ës dhe jo në gjashtëmujorin e parë.

Gjendja për periudhën TM3 2018

5.1/5.2) Edhe pse nuk kemi marrë përgjigje nga MTI brenda dhe pas afatit të paraparë me Ligjin për Qasje në Dokumente, sipas burimeve të tjera të informimit, projektligji për inspektimet nuk duket të jetë hartuar ende.

5.3/5.4/5.5) Sipas platformës konsultimet publike, koncept dokumenti nuk ka dalë në konsultim publik. Sipas përfaqësuesve të Kuvendit të Kosovës, ky projektligj nuk është miratuar ende edhe pse nuk kanë dhënë detaje nëse e kanë pranuar nga Qeveria. Kjo masë është paraparë të realizohet deri në fund të tremujorit të tretë të 2018-ës dhe prandaj konsiderohet e pa përmbushur.

Gjendja për periudhën TM4 2018

5.1) Koncept dokumenti për Ligjin për Inspektime ishte miratuar në mars 2018, prandaj ky veprim konsiderohet i plotësuar për vitin 2018.

5.2/5.3/5.4/5.5) Sipas raportit të fundit të Ministrisë për Integritet Evropiane, projektligji për Inspektime nuk është hartuar ende. Pasiqë projektligji nuk është hartuar, as konsultimet me shoqërinë civile, miratimi i ligjit nga qeveria dhe nga miratimi i ligjit nga kuvendi nuk janë zbatuar. Sipas përfaqësuesve të Kuvendit të Kosovës, ky projektligj nuk është miratuar nuk është kanë pranuar nga Qeveria as në tremujorin e katërt 2018. Prandaj, këto veprime konsiderohen si të paplotësuara për vitin 2018.

6	Miratimi i legjislacionit sekondar për ndihmë shtetërore dhe funksionalizimi i Komisionit dhe Departamentit për Ndihmë Shtetërore	6.1) Miratimi i legjislacionit sekondar për ndihmë shtetërore	MF	TM2 2018	PJ
		6.2) Funksionalizimi i Departamentit për Ndihmë Shtetërore	MF	TM2 2018	P
		6.3) Funksionalizimi i Komisionit për Ndihmë Shtetërore	KUVENDI	TM2 2018	PJ

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

6.1) Ligji për Ndhimën Shtetërore është miratuar më 23 dhjetor 2016 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare më 17 janar 2017. Deri më tani më janë draftuar dy rregullore: draft-rregullorja për procedurat e njoftimit të Ndhimës Shtetërore dhe draft-rregullorja për punën e Komisionit të Ndhimës Shtetërore.

Edhe pse e paraparë të përfundojnë në tremujorin e dytë të 2018-ës, hartimi i legjislacionit dytësor dhe rishikimi i dy rregulloreve të draftuara për funksionimin e DNSH pritet të përfundojnë në muajt në vijim. Draft-rregullorja për Procedurat dhe Formatin e Njoftimit për Ndhimë Shtetërore e finalizuar nga Grupi Punues dhe tashmë gjendet në Departamentin Ligjor për konsultimet finale para se të del në konsultime publike.

6.2) Gjatë vitit 2017, ka përfunduar procesi i bartjes së stafit, asetëve dhe të buxhetit nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) në Ministrinë e Financave si dhe është emëruar Drejtori i Departamentit të Ndhimës Shtetërore. Departamenti për Ndhimë Shtetërore është kompletuar me staf në maj 2018, dhe vazhdon me përgatitjen e akteve nënligjore që rregullojnë fushën e ndihmës shtetërore në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian. Ndërkohë, është ndryshuar dhe plotësuar Rregullorja për Organizim të Brendshëm në MF-së më 15 nëntor 2017, ku është përmbyllur themelimi i këtij Departamenti. Funksionet e Departamentit të ndihmës shtetërore janë të rregulluara me nenin 8 të Ligjit nr.05/L-100 për Ndhimën Shtetërore.

6.3) Komisioni për Ndhimë Shtetërore duhet të emërohet nga Kuvendi dhe ligji parasheh që të përbëhet nga pesë anëtarë të cilët nuk janë aktivë në politikë me një mandat tre vjeçar. Konkursi për përzgjedhjen e kandidatëve është shpallur në korrik 2018, pra pas tremujorit të dytë të 2018-ës. Pas përfundimit të infrastrukturës ligjore dhe emërimit të Komisionit për Ndhimë Shtetërore, DNSH-ja do të krijoj inventarizimin dhe skemën për ndihmën shtetërore.

Gjendja për periudhën TM3 2018

6.1) Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ndhimës Shtetërore (KNSh) është hartuar nga Grupi punues, mirëpo duhet miratuar nga Komisioni i Ndhimës Shtetërore dhe meqë ky komision ende nuk është emëruar as rregullorja nuk është miratuar. Po ashtu është hartuar Rregullorja për Procedurat e Njoftimit e cila ka kaluar të gjitha fazat e obligueshme legjislative përfshirë konsultimet e brendshme dhe publike dhe tani është në fazën finale për aprovim në qeveri. Mirëpo, asnjëra nuk është aprovuar në afat të paraparë.

6.2) Departamenti për Ndhimë Shtetërore është funksionalizuar gjatë gjashtëmujorit të parë 2018.

6.3) Komisioni për Ndhimë Shtetërore nuk është funksionalizuar. Konkursi për aplikim ishte publikuar në korrik të këtij viti dhe në këtë periudhë Kuvendi është në procesin e intervistimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për KNSh.

Gjendja për periudhën TM4 2018

6.1) Sipas Ministrisë së Financave (MF), Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Ndhimës Shtetërore (KNSh) aprovohet nga vet Komisioni. Pasiqë ende nuk është funksionalizuar KNSh-ja edhe kjo rregullore mbetet pa u hartuar dhe miratuar. Ndërsa, Rregullorja për Procedurat e Njoftimit të Ndhimës Shtetërore është miratuar në mbledhjen e Qeverisë të mbajtur më 23 Tetor 2018. Rregullorja është përafuar me legjislacionin e BE përfshirë edhe me Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 794/2004 me mbështetjen e ekspertëve të një projekti të BE-së. Meqenëse jo të dyja rregulloret janë hartuar dhe miratuar sipas afatit të paraparë, ky veprim mbetet pjesërisht i plotësuar për vitin 2018.

6.2) Ky veprim ka përfunduar në fund të gjashtë mujorit të parë të 2018-ës dhe prandaj vlerësohet si i plotësuar për vitin 2018.

6.3) Sipas përfaqësuesve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni përzgjedhës i Komisionit për Ndhimë Shtetërore ka proceduar për seancë plenare raportin me rekomandim më 12 dhjetor 2018. Votimi i kandidatëve pritet të bëhet në seancën e radhës, pra në vitin 2019. Meqenëse, ky veprim nuk është zbatuar në afatin e përcaktuar, konsiderohet si pjesërisht i plotësuar për vitin 2018.

7	Zbatimi i planit të veprimit për të luftuar ekonominë joformale	7.1) Realizohen vlerësime të pavarura sektoriale të rrezikut	MF	TM3 2018	P
		7.2) Rishikohet/Miratohet Plani i Veprimit duke marrë parasysh të gjeturat nga vlerësimi i rrezikut	MF	TM3 2018	P
		7.3) Përmirësohet më tej pajtueshmëria tatimore dhe zbatimi në mënyrë që të mbrohet interesi i fiskal i vendit	MF ATK DOGANA	TM3 2018	P
		7.4) Fuqizohet qasja ndër-institucionale dhe mekanizmat në fushën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit, përfshirë parandalimin, hetimet, vlerësimet dhe operimet	MF ATK DOGANA NJIF	TM3 2018	P
		7.5) Raporte të rregullta tremujore, të përgatitura, konsultuara dhe publikuara	MF	TM3	P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

7.1) Vlerësimet e pavarura sektoriale ndaj ekonomisë joformale, krimeve financiare, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit janë paraparë të përfundojnë në tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Në vitin 2017 janë vlerësuar sektori i lojërave të fatit dhe sektori i ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme. Ndërkaq gjatë muajit qershor 2018 është përfunduar vlerësimi i rrezikut në sektorin e OJQ-ve duke kompletuar kështu tri vlerësime të rrezikut. Pas kryerjes së vlerësimit të rrezikut, grupi punues ka miratuar raportet përfundimtare dhe i ka dorëzuar për miratim në Ministrinë e Financave.

7.2) Përveç vlerësimeve sektoriale, është bërë edhe një vlerësim i nivelit të përgjithshëm të ekonomisë joformale me ç’rast në tetor 2017 u krijua Sekretariati i ri i Grupit të Përhershëm për Parandalimin e Ekonomisë Joformale. Raporti përfundimtar i vlerësimit të ekonomisë joformale së bashku me vlerësimet e rrezikut ka shërbyer për hartimin e planit të veprimit për vitin 2018 që u miratua në qershor të këtij viti. Këto të gjetura do të shërbejnë edhe për hartimin e strategjisë së re për luftimin e ekonomisë joformale dhe pastrimin e parave 2019-2024 që do të shqyrtohet gjatë 2018-ës.

7.3) Administrata Tatimore e Kosovës edhe gjatë vitit 2017 ka realizuar të hyra më të mëdha se një vit më parë, por edhe në 2018 deri në fund të marsit ka realizuar të hyra në vlerë afro 80.3 milionë euro, sipas raportimit në MIE për gjashtëmujorin e parë 2018. Për tremujorin e parë 2018, ka realizuar 7,084 vizita përmes të cilave ka lëshuar 555 gjoba mandatore. Gjithashtu ka pasur rreth gjysmë milioni euro ulje të kreditimit të TVSh-së dhe rreth 2 milionë euro zbritje të humbjes. Ndërsa për këtë periudhë janë realizuar 220 kontrolle dhe afro 9 milionë euro humbje e zbritur. Po ashtu ka realizuar 595 vizita tek bizneset e pa fiskalizuara dhe bizneset të cilat nuk lëshojnë kuponë fiskal me ç’rast janë shqiptuar 171 gjoba mandatore në vlerë rreth 35 mijë euro. Në tre muajt e parë ka pasur 46 aktivitete kundër shmangies tatimore, 29 intervista me të dyshuar dhe dëshmitarë, 67 konsultime me prokurorë dhe ka hapur 10 raste për dyshim të shmangies tatimore. Po ashtu janë këmbyer 22 informata të inteligjencës me NJIF, Policinë dhe Doganën e Kosovës.

7.4) Kosova është anëtarësuar në organizatën Egmont Group të Njërive të Inteligjencës Financiare (Egmont Group of Financial Intelligence Units) në shkurt 2017. Egmont Group është organizatë ndërkombëtare me 152 njësi të inteligjencës financiare të specializuara në luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Përmes anëtarësimit, Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës (NJIF) ka qasje direkte në uebfaqen Egmont Secure për shkëmbimin ndërkombëtar të informatave të inteligjencës financiare. Numri i kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar është rritur si rezultat i anëtarësimit gjatë vitit 2017, por edhe 2018. Si rrjedhojë, gjatë tremujorit të parë të 2018, NJIF ka pranuar 37 (IRD) kërkesa për informata nga agjencitë zbatuese të ligjit, ndërsa nga ana e NJIF-it, tek entitetet raportuese dhe agjencitë zbatuese të ligjit janë dërguar 69 (ORD) kërkesa për informacione. Ndërkombëtarisht janë pranuar 3 (IRI) kërkesa për informata dhe 3 (ORI) kërkesa për informata ka dërguar NJIF tek homologët ndërkombëtar. Kështu, NJIF ka lëshuar një urdhër për ngrirje në shumë prej afro 230 mijë euro dhe 26 mijë dollarë amerikan ndaj një kompanie vendore. Po ashtu kanë marrë pjesë në takime ndërkombëtare të ndërlidhura me vlerësime të rrezikut si dhe si anëtarë të Egmont Group.

7.5) Raportimi tre-mujor nga Ministria e Financave është dashur të fillojë në vitin 2017. Kjo objektivë është shtyrë që të finalizohet deri në fund të muajit shtator 2018. Megjithëkëtë, sipas raportimit në MIE, raportet për vitin 2015 dhe 2016 janë përgatitur dhe publikuar në ueb-faqen e Ministrisë së Financave. Sipas uebfaqes së MF-së, raporti vjetor financiar 2017 është publikuar në prill. MF ka përpiluar edhe raportin tre-mujor financiar për periudhën janar-mars i publikuar në maj 2018, megjithëse më shumë se një muaj më vonë se përfundimi i tremujorit të parë. Pritet të shihet nëse edhe raportet tremujore të radhës do të publikohen me rregull.

Gjendja për periudhën TM3 2018

7.1) Vlerësimet e pavarura sektoriale janë kryer në gjashtëmujorin e parë dhe nuk është paraparë asnjë vlerësim tjetër sektorial. Gjithsej këto tri vlerësime janë aprovuar në Qeveri:

- Analiza e vlerësimit të rrezikut të sektorit të ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme (22.06.2018, Vendimi Nr.10/52)
- Analiza e vlerësimit të rrezikut për Lojëra të fatit (22.06.2018, Vendimi Nr.10/52)
- Analiza e vlerësimit të rrezikut për OJQ (18.09.2018, Vendimi Nr. 04/66)

7.2) Ka përfunduar në gjashtëmujorin e parë. Të gjeturat nga analiza e pavarur do të shërbejnë për hartimin e planit të veprimit 2019-2024.

7.3) Gjatë periudhës raportuese janar-shtator 2018, Administrata Tatimore e Kosovës ka realizuar të hyra në vlerë prej rreth 347 milionë euro, rreth 36 mijë vizita ku ka lëshuar 4,984 gjoba. Vlera e tatimit shtesë vlerësohet të jetë rreth 5.4 milionë euro. Gjithashtu ka pasur rreth tre milionë euro ulje të kreditimit të TVSh-së dhe rreth 4.2 milionë euro zbritje të humbjes. Po ashtu, janë realizuar 1,164 kontrole ku kanë mbledhur 35.4 milionë euro tatim shtesë me kreditim të zbritur afro 8 milionë euro dhe afro 24 milionë euro humbje e zbritur. Sa i përket arkës fiskale, ka realizuar 4,262 vizita ku ka shqiptuar 1,703 gjoba në vlerë prej afër 318 mijë euro.

Dogana e Kosovës dhe agjencionet tjera jashtë saj kanë realizuar 92 operacione në tremujorin e parë, numër shumë i madh se i periudhës së njëjtë vitin e kaluar ku gjithsej ishin 25 operacione të përbashkëta. Për tremujorin e dytë, vetëm me Policinë Kufitare, janë realizuar 6 operacione të përbashkëta, ndërsa 24 operacione me Prokurorinë, ATK dhe akterë tjerë të zbatimit të ligjit përmes Drejtorisë së Zbatimit të Ligjit (DZL). Gjatë tremujorit të tretë, janë realizuar 158 plane operative të përbashkëta me institucione tjera të zbatimit të ligjit si Policia e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, KFOR etj.

7.4) Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës (DHTI) për parandalimin e krimit financiar e korrupsionit ka realizuar këto aktivitete për nëntë muajt e kaluar 2018 ka realizuar: 237 aktivitete me qëllim të verifikimit të deklarimeve të sakta apo jo, për shmangie tatimore; 145 intervista me të dyshuar dhe dëshmitarë; 227 takime-konsultime me prokurorë të rasteve; 17 kallëzime penale; 27 raporte finale hetuese për Prokurorinë e Shtetit; 8 raporte të kontrollit; 16 bastisje; 11 aksione të përbashkëta me Doganën e Kosovës dhe një me Policinë e Kosovës; 40 raporte informuese për Policinë e Kosovës, Prokurorinë, e të tjera; 44 informata kthyesë për NJIF-in, 37 informata për Policinë e Kosovës dhe 13 informata për Doganën e Kosovës;

Ndërkaq për të njëjtën periudhë, NJIF ka 14 raporte për dyshimet e financimit të terrorizmit nga subjektet raportuese (TFR) dhe 3 raporte të transaksioneve të dyshimta (STR) lidhur me financimin e terrorizmit (FT). Ndërkaq 37 kërkesa shkëmbyese janë realizuar për analizimin e rasteve lidhur me aktivitetet financiare të individëve apo grupeve radikale dhe ekstremiste, nga të cilat 21 kërkesa janë bërë nga ana e NJIF-it dhe 16 kërkesa nga vendet e Grupit EGMONT për NJIF-in.

Dogana e Kosovës në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar ka shkëmbyer 105 korrespondenca me administratat e vendeve tjera, ku prej tyre me vendet e BE-së 23 , përderisa për periudhën e njëjtë të vitit paraprak (2017) janë shkëmbyer 20 korrespondenca me vendet e BE-së.

7.5) MF ka publikuar raportin gjashtë-mujor financiar për periudhën janar-qershor në gusht 2018, por ende nuk ka publikuar raportin tremujor për periudhën korrik-shtator 2018, por pritet të publikohet brenda muajit pasues i cili ende nuk ka përfunduar. Po ashtu, MF ka bërë publikimin e Raportit Vjetor 2017 për Parandalimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare në Kosovë (2014-2018) në ueb faqen e MF-së, në të tri gjuhët zyrtare.

Gjendja për periudhën TM4 2018

7.1/7.2) Janë kryer të gjitha obligimet brenda këtyre veprimeve në periudha të mëhershme të 2018-ës, andaj konsiderohen si të plotësuara.

7.3) Administrata Tatimore e Kosovës edhe në tremujorin e katërt 2018 ka vazhduar të punojë në pajtueshmërinë tatimore në mënyrë që mbrohet interesi fiskal i vendit. Sipas MF-së për periudhën tetor-dhjetor 2018, ATK ka realizuar të hyra në vlerë 121,288,187 euro dhe ka realizuar rreth 11 mijë vizita, të cilat kanë rezultuar me:

- o qarkullim shtesë në vlerë rreth 43.5 milionë euro,
- o tatim shtesë në vlerë rreth tre milionë euro,
- o ulje e kreditimit të TVSh-së në vlerë 986 mijë euro dhe
- o zbritje e humbjes në vlerë prej afro katër milionë euro.

Ndërsa sa i përket kontrolleve për periudhën raportuese janë realizuar, janë realizuar 545 kontrolle dhe sa i përket vizitave për arkë fiskale, janë gjithsej 797 sosh, ku janë shqiptuar 282 gjoba mandatore në vlerë rreth 50 mijë euro. Meqë ATK vazhdimisht ka përmbushur obligimet e veta, ky veprim konsiderohet i plotësuar për vitin 2018.

7.4) Divizioni i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës në ATK, gjatë tetor-dhjetor 2018 ka zhvilluar këto aktivitete: 59 aktivitete, me qëllim të parandalimit të evazionit fiskal dhe verifikimit të saktësisë së deklarimeve; 54 intervista me të dyshuar dhe dëshmitarë; 70 takime dhe konsultime me prokurorë; 5 raste të iniciuara nën dyshimin për shmangie tatimore; 34 këmbime të informatave të inteligjencës; 47 kërkesa të shkëmbyera me vendet e Grupit EGMONT, një raport të pranuar nga subjektet raportuese për dyshimet e financimit të terrorizmit (TFR). Ky veprim është i plotësuar për vitin 2018.

7.5) MF ka publikuar raportin nëntë-mujor financiar për periudhën janar-shtator në tetor 2018, por ende nuk ka publikuar raportin për tërë vitin 2018. Megjithatë, periudha e raportimit nuk ka përfunduar, andaj ky veprim cilësohet si i plotësuar për vitin 2018.

8	Miratimi i pakos ligjore për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë, si dhe funksionalizimi i katër laboratorëve të metrologjisë	8.1) Avancimi dhe përditësimi i rregullt i uebfaqes	MTI	TM3 2018	P
		8.2) Organizimi i 10 punëtorive për informim të bizneseve dhe promovim të uebfaqes	MTI	TM3 2018	PJ
		8.3) Organizimi i 30 moduleve për zhvillim të kapaciteteve njerëzore sa i përket infrastrukturës dhe standardeve të cilësisë	MTI	TM3 2018	PJ
		8.4) Miratimi i 1,500 standardeve në fokus në zonën e harmonizuar	MTI	TM3 2018	P
		8.5) Furnizimi i laboratorëve metrologjik ekzistues	MTI	TM3 2018	P
		8.6) Hartimi i Ligjit mbi shërbime dhe konsultimet me shoqërinë civile dhe akterë tjerë relevant	MTI	TM3 2018	P
		8.7) Miratimi i Ligjit mbi shërbime	KUVENDI	TM3 2018	P
		8.8) Themelimi dhe funksionalizimi i pikës së vetme të kontaktit për shërbime	MTI	TM3 2018	PJ

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

8.1) Ueb-faqja e MTI-së është ridizajnuar dhe mbushur me të dhëna në 2017 dhe vazhdon të përditësohet në baza ditore edhe në 2018. Është një aktivitet në vazhdimësi.

8.2) Organizimi i 10 punëtorive ka filluar në 2016 dhe ka vazhduar në 2017, por nuk kanë përfunduar në tremujorin e katërt të vitit të fundit megjithëse me marrëveshjen me BE-në ashtu ishte paraparë. Në vitin 2017 janë mbajtur tryeza me bizneset në fushën e zbatimit të legjislacionit për ashensorë dhe komponentët e sigurisë; një punëtori për harmonizimin e legjislacionit horizontal për lëvizjen e lirë të mallrave. Gjatë vitit 2018 janë organizuar dy punëtori. Një punëtori për Sigurinë e Lodrave në kuadër të ngritjes së Infrastrukturës së Cilësisë në Republikën e Kosovës si dhe një punëtori për të diskutuar draftin final të Rregullores për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim ku ka pasur përfaqësues të bizneseve të fushës dhe ministrive relevante. Në maj dhe qershor 2018 janë mbajtur konferencë për shënimin e Ditës Botërore të Metrologjisë dhe manifestim për Ditën Botërore të Akreditimit.

8.3) Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve njerëzore në fushën e infrastrukturës dhe standardeve të cilësisë janë paraparë që deri në fund të vitit 2017 të përfundohen 30 module. Sipas raportit të MIE-së, nga shtatori në nëntor 2017 janë mbajtur trajnime për zyrtarët e Divizionit për Infrastrukturë të Cilësisë në MTI për:

- Mekanizmat e monitorimit dhe komunikimit në aktivitetet e mbikëqyrjes së tregut në sektorin e pajisjeve elektrike dhe elektronike
- Çështjet teknike të mbikëqyrjes së tregut - Kontrolltet në fushën e pajisjeve elektrike dhe elektronike
- Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ (RIA) në lidhje me hartimin e strategjive dhe legjislacionit
- Sfidat dhe mundësitë në fushën e pajisjeve elektrike dhe elektronike

Gjatë vitit 2018 zyrtarët e fushave relevante kanë marrë pjesë në trajnime apo takime pune të ndryshme jashtë vendit, si më poshtë:

- Takim pune me institucionet e Infrastrukturës së Cilësisë, organizuar nga projekti Infrastruktura e Cilësisë në Vendet e Ballkanit Perëndimor, financuar nga SIDA në Stockhom
- Takimi i Komitetit Drejtues të Projektit SIDA në Stockholm
- Forumi Regjional për Mbikëqyrjen e Tregut në Sarajevë
- Trajnim në lidhje me zbatimin e ISO/IEC 17025:2017 (NE16) në Beograd
- Konferencë për Metrologjinë ligjore (NE17) në Beograd

8.4) Gjatë vitit 2017 janë miratuar 647 standarde si standarde të Kosovës (22 në miniera dhe minerale, 82 në tekstil dhe këpucë të lëkurës, 36 në teknologji agro-ushqimore, 95 në makineri, 107 në energji, 111 në shëndetësi, 34 në metrologji, 143 në përpunim të drurit, 14 në teknologji informative). Ndërkaq gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, Komitetet Teknike në kuadër të Agjencisë Kosovare për Standardizim (AKS) kanë adoptuar 544 standarde evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO/IEC, të cilat janë adoptuar si standarde kosovare në fushat si ne vijim: 167 në Mjedis, 74 në Derivate të Naftës dhe Gazit, 1 në Metrologji si dhe 312 në elektroteknikë. Gjithsej për një vit e gjysmë janë miratuar 1191 standarde.

8.5) Ka përfunduar furnizimi me pajisje për 6 laboratorë, atë të presionit, metaleve të çmuara, forcës, matjen e temperaturës dhe lagështisë relative, si dhe laboratorin e kohës dhe frekuencës. Gjithashtu është realizuar edhe trajnimi dy ditor për aftësimin e stafit për përdorimin e laboratorëve në fjalë. Në baza vjetore është duke u bërë furnizimi me pajisje të laboratorëve metrologjik ekzistues. Për vitin 2018, është shpallur tenderi për furnizim me pajisje laboratorike dhe se shpejti pritet të bëhet hapja e ofertave.

8.6/8.7) Hartimi i projektligjit për shërbime, konsultimet dhe miratimi i tij janë kryer gjatë vitit 2017. Ligji është miratuar dhe publikuar në gazetën zyrtare me 3 prill 2017.

8.9) Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Funkcionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit është hartuar në 2017, por është miratuar nga Qeveria më 16 mars 2018. Por, pika e vetme e kontaktit ende nuk është funksionalizuar.

Gjendja për periudhën TM3 2018

8.1) Ka përfunduar si masë më herët dhe ueb faqja vazhdon të përditësohet me informata.

8.2/8.3/8.4/8.5) Nuk ka informacion. MTI refuzon të përgjigjet.

8.6/8.7) Kanë përfunduar në periudhë të mëhershme.

8.8) Nuk ka informacion. MTI refuzon të përgjigjet.

Gjendja për periudhën TM4 2018

8.1) Ka përfunduar si masë më herët dhe ueb faqja vazhdon të përditësohet me informata.

8.2/8.3) Edhe pse MTI vazhdon të mos na ofrojë informata rreth implementimit të objektivave të ERA-së që i përkasin këtij institucioni, sipas raportit të fundit të MIE, gjatë vitit 2018 nuk ka pasur organizime të reja për informim të bizneseve dhe module për zhvillim të kapaciteteve. Meqë nuk është plotësuar numri i paraparë për këto dhe afati ka përfunduar në tremujorin e tretë 2018, këto veprime konsiderohen si pjesërisht të plotësuara.

8.4) Sipas raportit të MIE të publikuar në fund të vitit 2018, deri në fund të tremujorit të tretë të 2018, janë miratuar gjithsej 1,533 standarde. Pasiqë kjo objektivë parasheh miratimin e 1500 standardeve, ky veprim konsiderohet i plotësuar për vitin 2018.

8.5) Njëjtë, sipas raportit të MIE të publikuar në fund të vitit 2018, përveç furnizimit me pajisje për gjashtë laboratorë siç cekën më lartë, janë kompletuar me pajisje edhe laboratorit i vëllimit dhe laboratorit për matje elektrike është pajisur me mjete shtesë për kalibrim të radarëve. Si rrjedhojë, konsiderojmë që ky veprim është i plotësuar për vitin 2018.

8.6/8.7) Kanë përfunduar në periudhë të mëhershme, prandaj vlerësohen si të plotësuara për vitin 2018.

8.8) MTI refuzon të përgjigjet, por raporti i MIE-së thotë se kjo pikë do të jetë në formë të uebfaqes ku mund të ndërveprojnë shumë institucione dhe si rrjedhojë MTI ende po konsultohet me institucione dhe nuk ka funksionalizuar pikën megjithëse mënyra e funksionimit të kësaj pike është miratuar në mars 2018. Pasiqë afati për zbatimin e kësaj objektivë ka kaluar në tremujorin e vitit të kaluar, ky veprim konsiderohet si pjesërisht i plotësuar për vitin 2018.

9

Zbatimi i prokurimit elektronik në prokurimet e centralizuara

9.1) Zbatimi i prokurimit elektronik në prokurimet e centralizuara vazhdon

MF

TM3 2018

P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

9.1) Gjatë vitit 2017, janë zbatuar ndryshimet e ligjit të prokurimit në platformën elektronike, janë trajnuar e certifikuar zyrtarët në nivel lokal dhe qendror si dhe qeveria ka filluar publikimin e të dhënave standard të kontratave të prokurimit. Të gjitha veprimet e parapara janë përfunduar. Tenderimi në vlera të mëdha dhe të mesme është duke u kryer në mënyre elektronike.

Gjendja për periudhën TM3 2018

9.1) Ka përfunduar në periudha të mëhershme. Kemi konstatuar se tenderimi për vlera të mëdha dhe të mesme vazhdon të kryhet përmes e-prokurimit.

Gjendja për periudhën TM4 2018

9.1) Tenderimi për vlera të mëdha dhe të mesme vazhdon të kryhet përmes e-prokurimit, pra ky veprim konsiderohet i plotësuar për vitin 2018.

III. STATISTIKAT

MASA	VEPRIMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PERIUDHA	2018	
10	Zhvillimi i statistikave sektoriale të biznesit, energjisë dhe atyre sociale	10.1) Vonesat e publikimit, të reduktuara për PBB-të vjetore dhe tremujore përkatëse dhe statistikave të llogarive të qeverisë, përfshirë këtu publikimin në kohë të statistikave financiare të qeverisë me metodologjinë e ESA 2010	ASK	TM3 2018	P
		10.2) Prodhimi dhe publikimi i statistikave afatshkurtra të biznesit, të përmirësuara (vëllimit të prodhimit industrial dhe indekset e çmimeve)	ASK	TM3 2018	P
		10.3) Rezultatet nga statistikave të Anketës së Fuqisë Punëtore, të shpërndara në baza tremujore, dhe cilësia e tyre, e përmirësuar;	ASK	TM3 2018	P
		10.4) Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës	ASK	TM3 2018	P
		10.5) Publikimi i statistikave të energjisë, të reduktuara dhe statistikave vjetore të efikasitetit të energjisë, të prodhuara në përputhje me standardet ndërkombëtare	ASK	TM3 2018	P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

10.1) Aktualisht, BPV publikohet rregullisht në baza tremujore (kuartale) sipas metodologjisë së ESA2010 dhe sipas kalendarit të Eurostat-it (T+ 90 ditë). Po ashtu, afati për publikimin e BPV vjetore është shkurtuar. Llogaritë qeveritare për tremujorin e parë 2018 janë publikuar më 22 qershor 2018. Publikimet e mësipërme bëhen në përputhje me ESA 2010 ku metodologjia është zbatuar rreth 36%.

10.2) Statistikat dhe publikimi i prodhimit industrial është dashur të finalizohen në fund të vitit 2017. Mirëpo, në 2017 janë publikuar të dhëna vetëm për qarkullimin në prodhimin industrial sipas aktiviteteve ekonomike. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar për herë të parë parë rezultatet e Statistikave Afatshkurtra të Industrisë, më 29 qershor 2018, i cili përfshin indeksin e vëllimit industrial për tremujorin e parë (TM1) 2018 (2017=100). Ndërsa, më 12 mars 2018, u publikua indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për vitin 2017.

10.3) Nga fillimi i prillit deri më 5 dhjetor 2017, ASK ka publikuar katër Anketa të Fuqisë Punëtore (AFP) në baza vjetore dhe tremujore sipas afatit të paraparë në Kalendarin e Publikimeve të ASK-së, thuhet në raportin e MIE. AFP-ja për tremujorin e katërt 2017 është publikuar më 19 mars 2018 dhe të dhënat vjetore u publikuan më 30 mars 2018. Sa i përket të dhënave të AFP-së për tremujorin e parë 2018 janë publikuar më 18 qershor 2018, ku shohim se iu janë dashur vetëm 18 ditë deri në publikim që tregojnë përmirësim në shpejtësinë e shpërndarjes së të dhënave.

10.4) Gjatë periudhës 1 prill - 30 nëntor 2017, janë realizuar aktivitetet përgatitore dhe planifikimi i kohës dhe resurseve për zhvillimin e anketës në terren. Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) për vitin 2017 është publikuar në uebfaqen e ASK-së më 12 qershor 2018.

10.5) Të dhënat e Anketës së Konsumit të Energjisë në Ekonomitë Familjare janë inkorporuar në Bilancin e Energjisë për vitin 2016. Më 14 shkurt 2017, u publikua bilanci i energjisë për tremujorin e katërt. Afati i publikimit të statistikave të energjisë është shkurtuar për 8 ditë krahasuar me vitin 2016. Statistikat e efikasitetit të energjisë për 2011-2016 (për sektorin e industrisë dhe ekonomive familjare) u publikuan për herë të parë më 9 mars 2018, ndërsa për sektorin e shërbimeve dhe të transportit do të publikohen në një periudhë të mëvonshme. Sipas vendimit të fundit të kryeministrit, këto duhet kryer deri në fund të shtatorit të këtij viti.

Gjendja për periudhën TM3 2018

10.1) PBB vazhdon të publikohet rregullisht në baza tremujore sipas metodologjisë së ESA2010 dhe sipas kalendarit të Eurostat-it (T+ 90 ditë). Publikimi është bërë në kohë dhe sipas afatit të publikimeve me datë 13 shtator 2018. Zbatimi i metodologjisë ESA 2010 është proces dhe në fazën e tanishme, zbatimi i saj vazhdon të jetë i pjesshëm.

10.2) Publikimet e statistikave afatshkurtra të biznesit për këtë tremujor, në baza mujore: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për periudhën korrik 2018; Statistikat e Tregtisë së Jashtme për periudhën korrik 2018; Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për periudhën gusht 2018; Statistikat e Tregtisë së Jashtme për periudhën gusht 2018. Publikimet në baza tremujore: Repertori i Ndërmarrjeve në Kosovë për TM2 2018; Statistikat e Transportit për TM2 2018 ; Bilanci i Energjisë në Kosovë për TM2 2018; Indeksi i Çmimeve të Importit për TM2 2018; Statistikat e Hotelerisë për TM2 2018; Indeksi i Çmimeve të Prodhimit TM2 2018; Indeksi i kostos së ndërtimit për TM2 2018; Statistikat afatshkurtra të Industrisë & Indeksi i Vëllimit Industrial për TM2 2018; Statistikat afatshkurtra të tregtisë me pakicë për TM2 2018.

10.3) Rezultatet e AFP janë publikuar me 17 Shtator 2018 për tremujorin e dytë 2018, në përputhje me kalendarin e publikimeve dhe sërish ka përmirësim të shpejtësisë së publikimit.

10.4) Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) për vitin 2017 është publikuar në uebfaqen e ASK-së më 12 qershor 2018. Anketa e ABEF-it, nuk zhvillohet në vitin 2018 dhe do të vazhdojë të mos zhvillohet deri në vitin 2020 për shkak se është e paraparë të realizohet çdo tri vite. Kjo anketë zëvendësohet me një ankete tjetër me gjithëpërfshirëse e ashtuquajtur Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetës (SILC), e cila ka filluar në vitin 2018 dhe të dhënat publikohen në vitin 2019.

10.5) Statistikat e bilancit të energjisë janë publikuar për TM2/2018, vetëm për sektorin e amvisërive dhe industrisë ndërsa, për sektorin e shërbimeve dhe të transportit nuk janë publikuar asnjëherë, planifikohet të fillohet në vitin 2020 për këta dy sektorë.

Gjendja për periudhën TM4 2018

10.1) Meqenëse llogaritë qeveritare publikohen në baza tremujore sipas kalendarit të Eurostat-it (T+ 90 ditë), llogaritë qeveritare për tremujorin e tretë 2018 janë publikuar më 14 dhjetor 2018, ndërsa për tremujorin e katërt 2018 do të publikohen më 3 mars 2019, sipas ASK-së. Po ashtu edhe BPV për TM3 2018 është publikuar me 28 dhjetor 2018. Sipas ASK-së, përputhshmëria me metodologjinë ESA 2010 vazhdon të jetë e pjesshme, por që pritet ta finalizojnë pilot-projektin në lidhje me metodologjinë për Financat e Qeverisë dhe Statistikat e Deficitit të Tepërt ku edhe pritet të dërgohen të dhënat në Eurostat në bazë të tabelave që i parasheh ESA 2010 për: Tab 0200, 0900, 2500 dhe 1100. Po ashtu një projekt së bashku me MF-në përkrahur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar ka bërë të mundshme që ASK-ja t'i përmirësojë të dhënat, sidomos tek klasifikimet sipas standardeve të ESA2010 dhe GFS2014. Prandaj, ky veprim vlerësohet i plotësuar për vitin 2018.

10.2) Publikimet e statistikave afatshkurtra të biznesit në baza mujore janë publikuar si më poshtë: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2018; Statistikat e Tregtisë së Jashtme për shtator, tetor, nëntor 2018. Publikimet në baza tremujore: Repertori i Ndërmarrjeve në Kosovë për TM3 2018; Statistikat e Transportit për TM3 2018; Bilanci i Energjisë në Kosovë për TM3 2018; Indeksi i Çmimeve të Importit për TM3 2018; Statistikat e Hotelerisë për TM3 2018; Indeksi i Çmimeve të Prodhimit TM3 2018; Indeksi i kostos së ndërtimit për TM3 2018; Statistikat afatshkurtra të Industrisë & Indeksi i Vëllimit Industrial për TM3 2018; Statistikat afatshkurtra të tregtisë me pakicë për TM3 2018. Ndërsa të njëjtat për TM4 (tetor-dhjetor) 2018 do të publikohen në mars 2019. Prandaj, ky veprim vlerësohet i plotësuar për vitin 2018.

10.3) Rezultatet e AFP janë publikuar me 17 Shtator 2018 për tremujorin e dytë 2018, në përputhje me kalendarin e publikimeve dhe sërish ka përmirësim të shpejtësisë së publikimit. Të dhënat e AFP për TM3 2018 janë publikuar më 17 dhjetor 2018, ndërsa publikimi i të dhënave të AFP-së për TM4 2018 do të publikohen më 19 mars 2019. Edhe ky veprim vazhdon të plotësohet dhe cilësohet si i tillë për vitin 2018.

10.4) Siç ka sqaruar ASK-ja dhe më parë, anketa e ABEF-it do të vazhdojë të mos zhvillohet deri në vitin 2020 për shkak se është e paraparë të realizohet çdo tri vite. Sa i përket Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetës (SILC), grumbullimi i këtyre të dhënave është bërë në maj-korrik 2018 ndërsa publikimi i tyre është paraparë më 23 dhjetor 2019. Ky veprim vlerësohet i plotësuar për vitin 2018 ngaqë ABEF publikohet dhe SILC është shtuar megjithëse jo në baza vjetore.

10.5) Statistikat e Bilancit të energjisë janë publikuar për TM3 2018. Ndërsa, ASK ka sqaruar se statistikave të eficiencës së energjisë për amvisëri dhe industri bëhen në baza vjetore apo më gjatë, andaj edhe publikimi i ardhshëm i tyre është paraparë në vitin 2020. Sa i përket statistikave në sektorin e transportit ato janë duke u publikuar në baza tremujore dhe duke u përmirësuar ndërsa për statistikave të shërbimeve është në proces mbështetja nga Komisioni Evropian përmes një projekti në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomike. Prandaj, vlerësojmë se ky veprim është i plotësuar për vitin 2018.

IV. AGJENDA E INTERKONEKTIVITETIT

11	Zbatimi i të gjitha “masave të buta” në kuadër të agjendës së inter-konektivitetit	11.1) Miratimi i Legjislacioni dytësor që rrjedh nga ai primar	MZHE ZRRE KOSTT	TM3 2018	P
		11.2) Krijimi i Tregut të përbashkët energjetik me Shqipërinë	MZHE ZRRE KOSTT	TM3 2018	PJ
		11.3) Krijimi i Tregut të aksioneve energjetike me Shqipërinë - KOSTT (një ditë përpara dhe brenda ditës)	MZHE ZRRE KOSTT	TM3 2018	PJ
		11.4) Zbatimi i Marrëveshjes ndërmjet KOSTT-EMS	MZHE ZRRE KOSTT	TM3 2018	PA
		11.5) Harmonizimi i Kodit të rrjetit të KOSTT me atë të ENTSO-E.	MZHE ZRRE KOSTT	TM3 2018	P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

11.1) Tërë legjislacioni dytësor është harmonizuar sipas Ligjeve primare të energjisë dhe është duke u zbatuar nga prill/maj 2017. Po ashtu, më 29 mars 2018, Qeveria ka miratuar Rregulloren për ‘One-Stop-Shop për energjinë e ripërtëritshme.

Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes është miratuar në shkurt 2017. Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike nuk ekziston më, dhe është zëvendësuar nga “Metodologjia për përcaktimin e çmimit të ofrimit të shërbimeve universale”, e cila është miratuar në prill 2017. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit është miratuar në shkurt 2017.

11.2/11.3/11.4) Sipas raportit të MIE, Republika e Kosovës ka investuar në ndërtimin e linjës së interkoneksionit 400kV me Shqipërinë. Megjithatë, përderisa KOSTT nuk është i pavarur për operimin e sistemit transmetues, kjo linjë nuk mundet të hyjë në funksion për shkak të humbjeve të mëdha. Kjo çështje mbetet peng i moszbatimit të marrëveshjes së arritur me palën serbe në Bruksel nga ana e Serbisë. Komitetit të Energjisë së fundmi i është kërkuar nga Qeveria Gjermane fasiliteti i negociatave mes KOSTT dhe EMS për shkak të vonësve të mëdha në operacionalizimin e linjës së interkoneksionit.

Sipas raportit të MIE, Furnizuesit e rinj për energji elektrike në Republikën e Kosovës janë:

- "KESC" j.s.c
- "HEP-KS" sh.p.k
- "GSA ENERGY" sh.p.k

- "SHARRCEM" sh.p.k
- "JAHA Company" sh.p.k
- Future Energy Trading and Exchange Dynamics" sh.p.k

11.5) Sipas raportit të MIE, bazuar në vendimet e Komunitetit të Energjisë, KOSTT ka transpozuar dispozitat nga Demand Connection Code (Rule 2016/1388) (shq. Kodi i Lidhjes së Kërkesës) dhe Requirements for Grid Connection of Generators (Rule 2016/631) (shq. Kërkesat për lidhjen në rrjet të gjeneratorëve) në Kodin e Rrjetit të KOSTT. KOSTT këtë proces e ka përfunduar. Draft versioni me transpozimet përkatëse i këtij Kodi është dërguar për shqyrtim/aprovim në Komisionin Qeverisës të Kodeve Operacionale (KQKO) dhe në fund dërgohet për aprovim në ZREE.

Gjendja për periudhën TM3 2018

11.1) Tërë legjislacioni dytësor është harmonizuar sipas Ligjeve primare të energjisë në vitin 2017.

11.2/11.3/11.4) Gjatë kësaj periudhe, tri grupet punuese me ndihmën e asistencës teknike nga USAID, (REPOWER-Kosovë dhe RIT Shqipëri), Nord Pool dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë të udhëhequr nga koordinаторët e dy vendeve, janë në procedura të realizimit të disa aktiviteteve, të cilat pritet të realizohen gjatë këtij viti dhe vitit në vijim. Në vazhdim të aktiviteteve të Grupeve Punuese për tregun e përbashkët të energjisë elektrike Kosovë – Shqipëri, me 11 tetor në Tiranë, janë takuar Grupet Punuese. Gjatë kësaj periudhe është përgatitur Plani i Veprimit i Grupeve Punuese për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike Kosovë – Shqipëri, është duke u realizuar studimi për kapacitetet ndërkufitare për ndarjen e rezervave, dhe në proces të identifikimit të zbrazëtirave ligjore, rregullativave për propozim dhe rishikim eventual të tyre në mënyrë që të eliminohen pengesat ligjore në funksionalizimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë – Shqipëri.

Sipas KOSTT, ky fundit në vazhdimësi është duke u angazhuar për gjetjen e zgjedhjes së kontestit me EMS, gjegjësisht në eliminimin e barrierave të EMS në implementimin e Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, në bashkëpunim me fasilitatorët nga Komuniteti i Energjisë. Edhe përkundër përkushtimit dhe angazhimit maksimal të KOSTT në këtë drejtim, deri më tani nuk ka ndonjë progres të arritur.

11.5) Në mbledhjen e fundit të Bordit të ZRRE në tetor janë amandamentuar: Kodi i Rrjetit, dhe Kodi i Matjes. Në kuadër të Kodit të Rrjetit është Kodi i Kycjes i cili përfshinë përmbajtjen kryesore të kodeve të përmendura Demand Connection Code (Rule 2016/1388) (shq. Kodi i Lidhjes së Kërkesës) dhe Requirements for Grid Connection of Generators (Rule 2016/631) (shq. Kërkesat për lidhjen në rrjet të gjeneratorëve).

Gjendja për periudhën TM4 2018

11.1) Të gjithë hapat e paraparë për këtë veprim janë realizuar në 2017 dhe one-stop-shop është finalizuar në 2018. Ky veprim cilësohet i plotësuar për vitin 2018.

11.2/11.3) Nga takimi i përbashkët i tri grupeve punuese në tetor 2018 është hartuar plani i përbashkët i veprimit. Ky plan është i ndarë në faza dhe faza e parë ka të bëjë me themelimin e tregut të përbashkët “një ditë para” (Bursa e energjisë), ky proces është përgatitur nga nëntori i 2018, por ka vonesa nga pala shqiptare në marrjen e vendimit final në Këshillin e ministrave për themelimin e Bursës. Kjo vonesë ka devijuar planin që Bursa të jetë operacionale në TM1 2019. Meqë ka progres, por nuk është zbatuar funksionaliteti i bursës së energjisë brenda afatit të paraparë, këto veprime konsideron pjesërisht të plotësuara.

11.4) Sipas përfaqësuesve, KOSTT-i vazhdon angazhimin e vet në gjetjen e zgjedhjes së kontestit me EMS, gjegjësisht në eliminimin e barrierave të EMS në implementimin e Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E, në bashkëpunim me vetë përfaqësuesit e ENTSO-E dhe ata nga Komuniteti i Energjisë, por fatkeqësisht ende nuk ka ndonjë progres të arritur. KOSTT insiston në implementimin e plotë të Marrëveshjes së Kycjes nga ana e EMS. Megjithatë ky veprim nuk varet vetëm nga Kosova, gjegjësisht KOSTT, prapëseparë ky veprim konsiderohet si i paplotësuar për vitin 2018 ngaqë nuk është zbatuar as në afatin e paraparë e as deri në fund të vitit të kaluar.

11.5) ZRRE ka raportuar harmonizimin e Kodit të Rrjetit të KOSTT me atë të ENTSO-E si dhe përveç kodit të kyçjes për të cilin është raportuar dhe më parë, edhe kodet tjera janë amendamentuar po ashtu sipas ligjeve të Kosovës e të cilat janë në përputhje me pakon e tretë të legjislacionit të EU. Prandaj, ky veprim konsiderohet si i plotësuar për vitin 2018.

V. ENERGJIA

MASA	VEPRIMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PERIUDHA	2018	
12	Rritja e sigurisë së energjisë dhe miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhës 2017-2026	12.1) Miratimi i strategjisë së energjisë 2017-2026 nga Kuvendi	MZHE	TM1 2018	P
		12.2) Miratimi i programit të zbatimit të strategjisë së energjisë 2018-2020	MZHE	TM1 2018	P
		12.3) Investimet e reja në gjenerimin e energjisë	MZHE	TM1 2018	P
		12.4) Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit për burimet e ripërtëritshme të energjisë	MZHE	TM1 2018	PJ
		12.5) Miratimi i Ligjit dhe Krijimi i fondit për Eficiencë të Energjisë	MZHE	TM1 2018	PJ

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

12.1) Kuvendi i Kosovës ka miratuar Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026 më 26 janar 2018. Strategjia u miratua me 41 vota për, 18 kundër dhe 9 abstenime. Strategjia ka dy objektiva kryesore: a) Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike dhe b) Integrimi në tregun rajonal të energjisë. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka prezantuar strategjinë e energjisë për periudhën 2017-2026, e cila sipas tij, synon krijimin e një sektori të zhvilluar të energjisë të padëmshëm për shëndetin.

12.2) Programi për zbatimin e strategjisë së energjisë ka filluar në shkurt 2018 (menjëherë pas miratimit të strategjisë së energjisë 2017-2026) dhe si i tillë ka përfunduar tashmë dokumenti, ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit publike (nga 14 maj deri më 1 qershor 2018) dhe janë marrë deklaratat/opinionet nga MIE, MF dhe zyra për planifikim strategjik. Dokumenti është duke u përgatitur tashmë për dërgim në qeveri për miratim. Meqenëse nuk është miratuar në 2017 siç ishte paraparë, programi për zbatim tani përfshin periudhën 2018-2020.

12.3) Në bazë të informacioneve nga ZRRE, MZHE raporton investimet në kuadër të burimeve të ripërtritshme të energjisë:

- Hidrocentrale me autorizime finale që kanë hyrë në operim, me kapacitet të instaluar janë: 31.25 MW.
- Në proces janë edhe kapacitetet e bazuara në autorizimet finale që janë lëshuar nga ZRRE për kapacitet prej 61.9 MW – Hidroenergji
- Energjia diellore fotovoltaike- në operim janë kapacitetet prej 0.6 kW dhe
- Energjia e erës- Në operim është kapaciteti prej 1.35, kurse autorizimi përfundimtar është lëshuar për kapacitetin prej 32.4 MW.

12.4) Sipas MZHE-së, plani i veprimit për burimet e ripërtritshme të energjisë (i rishikuar) është draftuar, është përkthyer në të tri gjuhët, është formatizuar dhe tashmë gjendet në fazën e konsultimit publik. Konsultimi publik do të zgjat nga 12 korriku deri më 1 gusht 2018, që do të thotë do të përfundojë në tremujorin e tretë. Posa të përfundojë kjo fazë e konsultimit do të procedohet tutje për marrje të opinionëve dhe miratim në qeveri. Megjithatë, sipas vendimit të Kryeministrit, miratimi i planit ka qenë i paraparë të përfundojë deri më 30 mars 2018.

12.5) Fondi për Eficiencë të Energjisë është pjesë e projekt ligjit për Eficiencë të Energjisë i cili tashmë është në procedura parlamentare për miratim. Ky Ligj përcakton kornizën ligjore të domosdoshme për promovimin dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë në Republikën e Kosovës. Ky Ligj rregullon aktivitetet që kanë për qëllim zvogëlimin e intensitetit energjetik në ekonominë kombëtare dhe që i kontribuojnë zvogëlimin të ndikimit negativ në mjedis të aktivitetëve që ndërlidhen me sektorin e energjisë. Meqenëse ligji nuk është miratuar atëherë as fondi relevant nuk është krijuar.

Gjendja për periudhën TM3 2018

12.1) Kuvendi i Kosovës ka miratuar Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës në janar 2018.

12.2) Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me anë të vendimit Nr. 01/57 më 17 korrik 2018.

12.3) Zbatimi i Planit Kombëtar të veprimit për burimet e ripërtëritshme të energjisë PKVBRE (2011-2020) ndodhet në proces të vazhdueshëm, ngase lejet e autorizimit të lëshuara nga ZRRE i obligojnë investitorët t'i respektojnë afatet ligjore për zhvillimin e projekteve nga burimet e ripërtrishme të energjisë. Investimet e reja gjatë këtij tremujori janë: gjeneratori me erë "Kitka" me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW më 11 gusht 2018, gjeneratori me panele fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MË, në lokacionin Madanaj/Kusar, KK Gjakovë më 3 tetor 2018.

12.4) Sipas MZHE-së, Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë është rishikuar në përputhje me kërkesën e Komunitetit të Energjisë. Drafti i kompletuar e i formatizuar i planit ka kaluar procedurën e diskutimit publik në periudhën 12 korrik - 1 gusht 2018, si dhe të gjitha procedurat e tjera ligjore pas të cilave mundësohet procedimi për miratim. Miratimi i këtij dokumenti ishte parashikuar të bëhej brenda periudhës në tremujorin e tretë. Mirëpo, ky afat kohor nuk është përmbushur për shkak të rezultateve të reja të dala lidhur me energjinë nga BRE, pas publikimit nga Eurostat-i më 1 gusht 2018 të raportit të bilancit të energjisë për vitin 2016 i punuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës. Bazuar në këtë, MZHE pas komunikimit me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë ka marrë rekomandimin për reflektimin në draftplanin e rishikuar për BRE të të dhënave të reja statistikore të konsumit të energjisë për vitin 2016, i cili proces ka filluar dhe është në vazhdim. Pas këtij riplotësimi dhe pas zbatimit të procedurave të nevojshme ligjore, draftplani planifikohet të procedohet për miratim brenda periudhës TM4 2018.

12.5) Projektligji i Eficiencës së Energjisë i proceduar në Kuvend është miratuar nga Komisioni përkatës në lexim të parë (më 12 korrik 2018) dhe në lexim të dytë (më 2 tetor 2018). Pritet votimi i draftligjit në Kuvend në përputhje me procedurat e mëtejshme të votimit. Projektligji ndodhet në procedurat parlamentare dhe është në përgjegjësi të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pas miratimit të projektligjit për EE nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet të fillojë procesi i themelimit të Fondit për Eficiencës të Energjisë, i parashikuar me ligj.

Gjendja për periudhën TM4 2018

12.1/12.2) Strategjia e Energjisë të Republikës së Kosovës është miratuar në kuvend në janar 2018 dhe programi për zbatimin e tij në korrik 2018, andaj këto veprime konsiderohet të plotësuara për vitin 2018.

12.3) Sa i përket investimeve të reja në gjenerimin e energjisë gjatë tremujorit të katërt 2018, sipas ZRRE, më 11 tetor 2018 ka filluar prodhimin gjeneratori i ri i cili shfrytëzon erën si burim të energjisë (BRE). Parku me erë "KITKA" gjendet në komunën e Kamenicës dhe ka kapacitet të instaluar prej 32.4 MË. Gjeneratori është ndërtuar sipas Procedurës për dhënie e Autorizimit për Ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE. Edhe ky veprim konsiderohet i plotësuar për vitin 2018 pasi që ka pasur investime të reja vazhdimisht dhe ato do të vazhdojnë edhe në vitet në vijim.

12.4) Sipas MZHE-së, Plani Kombëtar i Veprimit për BRE i rishikuar për periudhën 2018-2020 është finalizuar dhe është dërguar te Zyra e Planifikimit Strategjik për vlerësim paraprak para se të miratohet nga Qeveria. Plani Kombëtar i Veprimit për BRE 2011-2020 është në fuqi deri në miratimin e Planit të rishikuar. Meqenëse plani i rishikuar nuk është miratuar, ky veprim cilësohet si pjesërisht i plotësuar pasi që ka kaluar afatet e parapara për miratim.

12.5) Ligji për Eficiencë të Energjisë është miratuar më 2 tetor 2018 dhe ka hyrë në fuqi më 20 dhjetor 2018. Ndërkaq sa i përket Fondi për Eficiencë të Energjisë gjatë TM4 2018 është bërë emërimi i anëtareve të Bordit të Drejtorëve sipas kërkesave ligjore të ligjit përkatës. Me ndihmën teknike të Projektit nga Komisioni Evropian janë draftuar rregulloret e mëposhtme:

- Parimet e Përgjithshme dhe Kodi i Etikës i FKEE
- Rregullorja për organizimin e brendshëm të FKEE
- Rregullorja për rregullat e brendshme të punës së FKEE.
- Plani i zhvillimit të biznesit të FKEE që mbulon periudhën tre vjeçare.

- Rregullorja për përgatitjen e buxhetit vjetor.
- Standardet dhe procedurat e brendshme të kontabilitetit.
- Rregullorja për pagesën e stafit të FKEE.
- Rregullorja për procedurën dhe kriteret e punësimit të stafit FKEE.
- Rregullorja për përgatitjen dhe shpalljen e thirrjeve për propozime.

Miratimi i këtyre rregulloreve duhet të bëhet nga bordi i përzgjedhur dhe pritet që fondi të jetë plotësisht operacional në periudhën TM1/TM2 të 2019. Meqenëse përfundimi i miratimit të ligjit përkatës dhe krijimi të fondit kanë qenë të parapara të finalizohen në TM1 2018 dhe ende nuk janë finalizuar, pra Fondi përkundër arritjeve nuk është funksional, këtë veprim e cilësojmë si pjesërisht të plotësuar.

Tabela 3. Masat dhe veprimet për shtyllën Konkurrueshmëria dhe klima e investimeve .

PUNËSIMI DHE ARSIMI

I. PUNËSIMI

MASA	VEPRIMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PERIUDHA	2018
1	Përmirësimi i mundësive të punësimit, me fokus punësimin e të rinjve dhe grave.	MPMS	TM1 2017	P
			TM1 2017	P
			TM1 2017	P
			TM2 2017	P
			TM3 2017	P
			TM3 2018	P
			TM3 2018	P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

1.1) Realizimi i një vlerësimi të nevojave të tregut të punës (përfshirë mbi AAP) ka përfunduar më herët dhe parashihet të përdoret për qëllimet e definuara në pikën e sigurimit për zbatimin të ligjit mbi Agjencinë e Punësimit.

1.2) Projekt-rregullorja është hartuar për punën e Bordit Këshillëdhënës të Agjencisë së Punësimit, më datën 26.06.2018 dhe është dërguar në MIE për opinion ligjor rreth përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së dhe ka përfunduar të gjitha procedurat e parapara.

1.3) Asistenca përfshinë subvencion në pagë, punë publike, vetëpunësim, praktikë, trajnim dhe aftësim profesional. Për periudhën TM1 2018, numri i përfshirjes së grave në masat aktive të tregut të punës është 705. Në periudhën TM2 2018, numri është rritur në 1337.

1.4) Hulumtimi është kryer nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit, ku përfshihet edhe çështja e papunësisë së grave. Rezultatet e këtij hulumtimi do të përdoren nga MPMS, për hartimin e politikave të punësimit dhe aftësimin profesional.

1.5) Të gjeturat e hulumtimit do të përdoren për hartimin e Politikës së Punësimit 2019-2021, proces i cili ka filluar dhe do të përfundoj në fund të 2018. Synimi është që krijohen targete specifike për Agjencinë e Punësimit lidhur me punësimin e grave si në tregun e punës ashtu edhe në masa aktive të tregut të punës.

Gjendja për periudhën TM3 – TM4 2018

1.2) Drejtori i Përgjithshëm është zgjedhur. Nga Qeveria, është nxjerrë vendimi përmes të cilit janë emëruar anëtarët e Bordit Këshillëdhënës të Agjencisë së punësimit; gjithashtu është hartuar dhe miratuar draft rregullorja e APRK-së (31 korrik 2018).

1.5) Koorporata e Sfidave të Mijëvjeçarit, ka bërë një hulumtim nacional për përdorim të kohës dhe papunësisë, ku përfshihet edhe çështja e papunësisë së grave. Rezultatet e këtij hulumtimi do të përdoren nga MPMS, për hartimin e politikave të punësimit dhe aftësimin profesional.

1.6) Është hartuar dhe miratuar plani i veprimit për Punësim dhe Politikën Sociale.

1.7) Është hartuar dhe miratuar plani i veprimit për Punësimin e të Rinjve.

2	Miratimi dhe zbatim i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015-2020 dhe miratimi i Planit të Veprimit 2017-2018 për zbatimin e strategjisë	2.1) Miratimi i Strategjisë Sektoriale dhe Planit i saj i Veprimit;	MPMS MKRS MASHT	TM2 2017	P
		2.2) Ndarja e Buxhetit për zbatimin e Strategjisë Sektoriale.			P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

2.1) MPMS ka hartuar draft Strategjinë Sektoriale 2018-2022 si dhe Planin e Veprimit 2018-2022. Dokumenti është miratuar në qeverinë e Kosovës me datën 28.02.2018.

2.2) MPMS ka mbaruar të gjitha procedurat, përfshirë këtu ndarjen e buxhetit të paraparë.

II. ARSIMI

MASA	VEPRIMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PERIUDHA	2018	
3	Përmirësimi i cilësisë së arsimit.	3.1) Miratimi i pakos ligjore për reformën në sektorin e arsimit;	MASHT QEVERIA	TM3 2018	PA
		3.2) Rritja e vijueshmërisë në arsimin parashkollor;	MASHT	TM3 2018	PJ
		3.3) Zbatim i kurrikulës së bazuar në kompetencë për klasat 0, 1, 2, 6, 7, 11 dhe zhvillimi i kurrikulave për klasat 3, 8 dhe 12.	MASHT	TM3 2018	P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

3.1) Projektligji për Arsimin e Lartë ka kaluar fazën e diskutimit publik dhe tani është në fazën e shqyrtimit të komenteve nga grupi punues.

3.2) IPA dhe MASHT është në finalizim e sipër të ndërtimit të 6 çerdheve publike, 2 prej të cilave janë në proces të ndërtimit.

3.3) Nga viti shkollor 2017/18 në të gjitha shkollat e Kosovës, janë duke u zbatuar korniza e kurrikulës së Arsimin Parauniversitar, kurrikulat bërthamë për 3 nivelet e Arsimin formal (niveli I klasa 0,1-5, niveli II, klasat 6-9, niveli III, klasa 10-12) si dhe plan programet lëndore për klasën përgatitore 1, 6 dhe 10. Në vitin shkollor 2018/19 programet lëndore për klasat 2, 7 dhe 11 do të jenë pjesë e zbatimit të reformës në të gjitha shkollat e Kosovës.

Gjendja për periudhën TM3 – TM4 2018

3.1) Nuk ka zhvillime të reja për TM3.

3.2) E njëjta përgjigje. Nuk ka raportim shtesë.

3.3) Është realizuar redaktimi teknik i programeve mësimore për klasën përgatitore, klasat 1,6,10. Janë publikuar programet mësimore për klasën përgatitore, klasat 1,6,10, në web faqe të MASHT-it sipas klasave për secilën lëndë, të cilat zbatohen në gjitha shkollat e Kosovës në vitin shkollor 2018/2019. Gjithashtu është bërë redaktimi teknik i programeve mësimore për klasat 2,7,11. Janë publikuar programet mësimore për klasat 2,7,11 në web faqe të MASHT-it sipas klasave për secilën lëndë, të cilat zbatohen në të gjitha shkollat e Kosovës në vitin shkollor 2018/2019. Tutje, është bërë redaktimi teknik i draft programeve mësimore për klasat 3,8 dhe 12. Janë publikuar Draft programet mësimore, për klasat 3,8,12 në web faqe të MASHT-it sipas klasave për secilën lëndë, të cilat zbatohen në të gjitha shkolla pilot në vitin shkollor 2018/2019. Është bërë redaktimi teknik i draft programeve për Gjuhën shqipe për nxënësit e komuniteteve jo shqiptare për klasat 3,6 dhe 10. Janë publikuar draft programet mësimore, për Gjuhën shqipe për nxënësit e komuniteteve jo shqiptare për klasat 3,6 dhe 10, në web faqe të MASHT-it, të cilat zbatohen në të gjitha shkolla pilot, ku nxënësit e zgjedhin Gjuhën Shqipe për ta mësuar në vitin shkollor 2018/2019.

4	Miratimi i legjislacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit.	4.1) Miratimi i Projektligjit të rishikuar mbi arsimin e lartë;	MASHT	TM1 2017	PJ
		4.2) Miratimi i Plani Strategjik të Arsimit dhe Ndarja e buxhetit të nevojshëm për të siguruar zbatimin e PSAK;		TM4 2016	P
		4.3) Ndarja buxhetit të nevojshëm për të siguruar zbatimin e PSAK.		TM4 2016	PA

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

4.1) Projektligji i Arsimit të Lartë është finalizuar dhe ka kaluar procedurat e diskutimit publik. Janë pranuar komentet nga grupet e interesit dhe te njëjtat do t'i shqyrtojë grupi punues.

4.2) Ka filluar zbatimi i PSAK-ut 2017-21.

4.3) Zbatimi i PSAK-ut ka filluar zbatohet me një deficit buxhetor në vlerë prej 44 milionë EURO.

Gjendja për periudhën TM3 – TM4 2018

4.1) Diskutimi paraprak publik ka përfunduar. Departamenti i Arsimit të Lartë ka pranuar komentet nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera, të cilat grupi punues është duke i shqyrtuar. Grupi punues ka mbajtur 8 takime, ku janë shqyrtuar të gjitha rekomandimet e dalura nga debati publik, të cilat janë vendosur në memorandumun shpjegues sipas legjislacionit në fuqi. Ligji është në fazën finale në MASHT. Drafti i ligjit të Arsimit të Lartë është finalizuar dhe pritet vetëm të miratohet kostoja financiare e ligjit dhe do të dërgohet në MF dhe MIE.

4.3) Nuk ka zhvillime të reja për TM3.

5	Përmirësimi i cilësisë në arsim	5.1) Rritja e numrit të objekteve publike për kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0-5 vjeç.	MASHT	TM3 2017	PJ
		5.2) Korniza e Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Para-Universitar dhe syllabusi për klasat dhe lëndët është shqyrtuar dhe aprovuar me		TM4 2017	PJ

	zbatimin të mëpasshëm në të gjitha shkollat, duke filluar nga viti shkollor 2017/2018;		
	5.3) Mekanizmat për sigurimin e cilësisë të zhvilluara përmes emërimit të koordinatoreve të cilësisë në shkolla dhe krijimit të sistemit efikas për vlerësimin e performancës në shkolla;	TM2 2017	P
	5.4) Agjencia për Kurrikulë, Standarde dhe Vlerësim është themeluar dhe është plotësisht funksionale;	TM2 2017	PA
	5.5) Projektligji i rishikuar mbi inspektoratin e arsimit në Kosovë është miratuar nga Kuvendi dhe inspektorët kanë filluar aktivitetet e tyre, me inspektorë dhe kapacitete të mjaftueshme;	TM4 2017	P
	5.6) Krijimi dhe funksionalizimi i Këshillave Industriale;	TM2 2017	P
	5.7) Shqyrtimi i programeve studimore dhe politikave të regjistrimit.	TM3 2017	P

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

5.1) Është kryer verifikimi i lokacioneve për ndërtimin e 6 çerdheve të cilat do të financohen përmes fondeve të IPA II, 2016 me pjesëmarrje të MASHT. Nga këto 6 çerdhe, 2 janë në proces të ndërtimit në Kaçanik dhe Shtime, me financim të buxhetit të Kosovës është duke vazhduar ndërtimi i një çerdheje në Rahovec, gjithashtu është në procedurë të lidhjes së kontratës në MAP edhe ndërtimi i një çerdheje në Prizren. Po ashtu, është planifikuar ndërtimi i 2 çerdheve tjera në Prishtinë dhe Klinë.

5.2) Procesi i hartimit të plan programit bërthamë për edukim në fëmijërinë e hershme është në fazën e finalizimit, pasi i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara të diskutimit publik (27.04.18 - 21.05.2018). Janë marrë komentet dhe pritjet miratimi i saj. Pilotimi i tyre planifikohet të filloj në Shtator 2018.

5.3) Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në Tetor 2017, ku janë planifikuar edhe shkollat të cilat do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit. Planifikimi është bërë nga inspektorët e arsimit, në gjithsej 48 shkolla të arsimit parauniversitar. Janë emëruar gjithsej 200 koordinatore për sigurimin e cilësisë në të gjitha shkollat, dhe 24 koordinatore në nivel të drejtorive komunale të arsimit.

5.4) Në Mars 2018 është punuar në UA për themelimin e agjencionit me përkrahje të projektit ESIP të Bankës Botërore. Ky udhëzim parashihet të miratohet në Nëntor 2018. Andaj, Agjencia për Kurrikulë, Standarde dhe Vlerësim nuk është themeluar dhe nuk është funksionale.

5.5) Projektligji për Inspektoratin i ka kaluar të gjitha procedurat dhe tani do të kalojë për lexim të dytë dhe miratim në Kuvend.

5.6) Universiteti i Prishtinës, në 10 njësi akademike, ka themeluar 10 trupa këshillëdhënës; Universiteti i Ferizajit, ka themeluar 1 bord industrial; Universiteti i Gjakovës ka themeluar 2 trupa këshillëdhënës; Universiteti i Mitrovicës është në fazën e parë të hartimit të rregullores për trupat këshillëdhënës; Universiteti i Pejës ka themeluar 3 borde industriale; dhe Universiteti i Gjilanit ka miratuar rregulloren por ende nuk ka themeluar trupat këshillëdhënës.

5.7) Janë proceduar ankesat e institucioneve të arsimit të lartë, të cilat ishin mbetur të pa përfunduar nga mbledhja e 53-të e KSHC, dhe janë lëshuar vendime për ato.

Gjendja për periudhën TM3 – TM4 2018

5.1) Të dhënat tregojnë se në vitin 2016-2017, përfshirja në arsimin parashkollor (3-5 vjeç) ka qenë 33.9 %, ndërsa në atë para-fillor (5 vjeç) - 87.6 %. Kjo pjesëmarrje është rritur në vitin 2017-2018 në 36% për nivelin parashkollor përkatësisht 92.4% për nivelin para-fillor.

5.2) Korniza e Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Para-Universitar dhe syllabusi për klasat dhe lëndët është shqyrtuar dhe aprovuar me zbatimin të mëpasshëm në të gjitha shkollat, duke filluar nga viti shkollor 2017/2018.

5.3) Gjatë vitit 2018 janë planifikuar shkollat të cilat do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga inspektorë në të gjitha komunat e Kosovës. Secila komunë do të ketë nga një shkollë e cila do ti nënshtrohet vlerësimit të jashtëm. Qëllimi i vlerësimit është pasqyrimi i performancës së shkollës sipas Kornizës për Sigurimin e Cilësisë së Performancës. Në tremujorin e katërt të vitit 2018, duke u mbështetur në Ligjin 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, UA 04/2017 për Vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin Parauniversitar, UA 14/2018 për Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, Inspektorati i Arsimit ka kryer këto aktivitete: Vlerësimin i performancës së institucioneve arsimore në arsimin Parauniversitar e ka filluar në shtatë (7) shkolla të vendit. Aspektet kryesore për vlerësimin e performancës së shkollës janë: Fushat e cilësisë (aspekti vertikal i cilësisë), Kriteret e cilësisë (shtrirja) dhe Treguesit e performancës (thellësia e vlerësimit). Vlerësimin e performancës së shkollës e ka filluar me 217 mësimdhënës në mbi 60 shkolla të 25 komunave të Kosovës. Aspektet kryesore të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve janë: Fushat e cilësisë dhe Standardet e përcaktuara në Kornizën Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë.

5.4) Sipas draftit të organogramit të ri të MASHT, me rekomandim të BE, nuk do të ketë themelim të agjencionit, por do të fuqizohet divizioni për standarde vlerësim dhe monitorim.

5.5) Më 10 Gusht 2018 draft ligji i inspektoratit të arsimit është publikuar në gazetën zyrtare nr.13/10 gusht 2018. Nga data 27 Gusht Ligji i Inspektoratit të Arsimit 06 - L/046 ka hyrë në fuqi.

5.6) Të gjithë Trupat Këshillëdhënës ose Bordet Industriale i kanë draftuar dhe I kanë nënshkruar rregulloret e punës për nënshkrimin e tyre. Universiteti i Prishtinës, në 10 njësi akademike, ka themeluar 10 trupa këshillëdhënës; Universiteti i Ferizajit, ka themeluar 1 bord industrial; Universiteti i Gjakovës ka themeluar 2 trupa këshillëdhënës; Universiteti i Mitrovicës është në fazën e parë të hartimit të rregullores për trupat këshillëdhënës; Universiteti i Pejës ka themeluar 3 borde industriale; dhe Universiteti i Gjilanit ka miratuar rregulloren por ende nuk ka themeluar trupat këshillëdhënës.

5.7) KSHC ka mbajtur dy takime (mbledhja 57 dhe 58), ku janë shqyrtuar kërkesat e IAL. Po ashtu në mbledhjen e 58, Këshilli Shtetëror për Cilësi ka marrë vendim për tërheqjen e akreditimit të 63 programeve të Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (BPAL) dhe 15 programeve të IALP.

6	Përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë	6.1) Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës;	MASHT KKK Agjencia e Punësimit	TM1 2017	P
		6.2) Shqyrtimi i profileve të ofruara në shkollat e AAP-së;		TM3 2017	PJ
		6.3) Hartimi i kurrikulave bërthamë për AAP dhe fillimi i fazës së pilotimit;		TM2 2017	PA
		6.4) Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së;		TM3 2017	PA
		6.5) Zgjerimi dhe përfshirja në programet studimore.		TM3 2017	PA

Gjendja për periudhën TM1 – TM2 2018

- 6.1)** Është bërë hulumtimi i disa profileve si: përpunimi i ushqimit dhe paketimit, kontraktimi i shërbimeve jashtë vendit për teknologji informative dhe qendra të mbështetjes së konsumatorëve, përpunimin e metalit, tekstilit, turizmit dhe drurit. Janë nënshkruar marrëveshje me bizneset e përpunimit të drurit dhe shërbime dhe shitje. Gjithashtu, është realizuar panairi i punësimit.
- 6.2)** GIZ ka filluar një hulumtim në 68 shkolla profesionale dhe institucione tjera. Të gjeturat e raportit do të prezantohen në Tetor 2018, pastaj do të bëhet hulumtimi i tregut të punës.
- 6.3)** Është draftuar projekt propozimi si dhe diskutimi publik me donatorët por ende nuk ka mbaruar hartimi i saj.
- 6.4)** Është bërë analiza e kostos për disa profile (ekonomi, shëndetësi, etj) në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe GIZ, por nuk është siguruar financimi.
- 6.5)** Nuk ka filluar zgjerimi për programet studimore.

Gjendja për periudhën TM3 – TM4 2018

- 6.1)** Vlerësimi i nevojave të tregut të punës shfrytëzohet në analizat dhe hartimin e politikave të Ministrisë së Arsimit. Edhe konkurset për pranimin e nxënësve në shkollat profesionale këtë vit janë bazuar në kërkesat e tregut të rajonit përkatës. Bazuar në këtë, në disa raste, drejtoritë e arsimit kanë kërkuar hapje të profileve të reja.
- 6.2)** Me qëllim të harmonizimit të profileve profesionale në tregun e punës, me mbështetjen e GIZ, ka përfunduar hulumtimi në 68 shkolla profesionale, 8 qendra të aftësimit të MPMS, dhe 4 ofrues privat të AAP. Është prezantuar raporti mbi të gjeturat e hulumtimit. Ky raport shqyrton aspektet si organizimi dhe menaxhimi, rekrutimi dhe zhvillimi i stafit, cilësinë, përmbajtjen dhe atraktivitetin e programeve, gjendjen e objekteve dhe pajisjeve si dhe financimin. Ka filluar projekti rajonal, mësimi i bazuar në vend të punës në mes të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës si dhe projekti i njohjes paraprake, përkrahur nga ETF.
- 6.3)** Është hartuar drafti i parë i Kornizës së Kurrikulës së Arsimit dhe Aftësimit Profesional. Dokumenti i është nënshtruar të gjitha procedurave të diskutimit publik, ku janë marrë edhe inputet nga akterët relevant. Aktualisht, në dokument janë duke u adresuar komentet e palëve të interesit. Ndërsa Kurrikulat për 80 profile, për klasën e 10-të, do të hartohen në bazë të Kornizës së Kurrikulës të AAP. Janë identifikuar standardet për profesione prioritete të cilat do plotësohen apo hartohen dhe fillohet me kurrikulat.
- 6.4)** Sa i përket financimit të qendrave të arsimit dhe aftësimit profesional, me mbështetje të Bankës Botërore dhe GIZ, është bërë analiza e kostos për disa profile (shëndetësi ekonomi, dhe disa profile teknike) të cilat do ta plotësojnë formulën e financimit e cila do të zhvillohet, bazuar në Planin Strategjik të Arsimit 2017- 2021. Është bërë analiza e kostos së shpenzimeve për 2 vitet e fundit, për ti krahasuar me shpenzimet e tanishme. Në muajin korrik janë mbledhur të gjitha të dhënat për shpenzimet në shkollat profesionale nga thesari dhe janë duke u analizuar. Është duke e analizuar formula e financimit për arsim para universitar, në kuadër të së cilës analizë, parashihet edhe rishikimi i formulës për shkollat e arsimit profesional si pjesë e arsimit para universitar. Për këtë qëllim, është formuar edhe grupi punues me përfaqësues të Ministrisë së Financave.
- 6.5)** MASHT, me mbështetje të projektit “EYE” ka pilotuar sistemin dual të mësimin në vend të punës në 4 shkolla profesionale në bashkëpunim me bizneset. Bazuar në këtë pilotim, është hartuar udhëzimi administrativ i cili e rregullon mësimin në vendin e punës. Bizneset të cilat kanë interes për profesione të caktuara dhe që ofrohen në shkollat kanë mundësi t’i qasen shkollës dhe të zbatojnë në bashkëpunim të ngushtë praktiken profesionale sipas nevojave të tyre.

Tabela 4. Masat dhe veprimet për shtyllën Punësimi dhe Arsimi .



Embassy of the
Kingdom of the Netherlands

Ky Raport Monitorimi është pjesë e projektit me titull “Mekanizmi i Monitorimit të Agjendës për Reforma Evropiane”, që financohet nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, dhe implementohet nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti GAP, dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike.

legalpoliticalstudies.org

institutigap.org

pips-ks.org